

# RAPORTI VJETOR 2023

PRIORITETET PËR VITIN 2024



AUTORITETI I  
KONKURRENCËS

LISTË SHKURTIMESH.....	2
PJESA E PARË.....	4
1.1 Zbatimi i rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.....	4
PJESA E DYTË.....	17
ZBATIMI I LIGJIT TË KONKURENCËS.....	17
2.1 Tregjet e monitoruara.....	17
2.2 Marrëveshjet e ndaluara.....	23
2.3 Abuzimi me pozitën dominuese.....	27
2.4 Përfshirje nga ndalimi i marrëveshjeve.....	30
2.5 Kontrolli i përqendrimeve.....	30
2.5.1 Transaksione në tregun e brendshëm.....	34
PJESA E TRETË.....	47
AUTORITETI I KONKURENCËS PËRBALLË PROCESIVE GJYQËSORE.....	47
3.1 Çështje të gjykuara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.....	47
3.2 Çështje të gjykuara në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.....	47
3.3 Çështje të gjykuara në Gjykatën e Lartë.....	49
3.4 Ekzekutimi i vendimeve të komisionit të konkurrencës.....	50
PJESA E KATËRT.....	50
4.1 Vlerësimi i akteve dhe projektakteve normative.....	50
4.2 Advokacia e Konkurrencës.....	53
PJESA E PESTË.....	55
INTEGRIMI EVROPIAN dhe BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR.....	55
5.1 Kontributi në kuadrin e Integrimit Evropian.....	55
5.2 Memorandume Bashkëpunimi.....	56
5.3 Bashkëpunimi Ndërkombëtar.....	56
PJESA E GJASHTË.....	58
ORGANIZIMI I AUTORITETIT.....	58
6.1 Organizimi i Autoritetit të Konkurrencës.....	58
6.2 Realizimi i buxhetit për vitin 2023.....	59
6.3 Të ardhurat e realizuara.....	61
6.4 Trajnimet dhe rekrutimet.....	61
PJESA E SHTATË.....	63
PRIORITETET E AK PËR VITIN 2024.....	63
7.1 Prioritetet e AK për vitin 2024.....	63
7.2 Përafrimi institucional me standardet dhe praktikat e BE.....	63

## LISTË SHKURTIMESH

<b>AK</b>	Autoriteti i Konkurrencës
<b>AKEP</b>	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
<b>AMF</b>	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
<b>APP</b>	Agjencia e Prokurimit Publik
<b>BE</b>	Bashkimi Europian
<b>BERZH</b>	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
<b>BSH</b>	Banka e Shqipërisë
<b>ERE</b>	Enti Rregullator i Energjisë
<b>ERRU</b>	Enti Rregullator i Ujit
<b>FNT</b>	Fuqi të ndjeshme në treg
<b>FSDKSH</b>	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
<b>FSHF</b>	Federata Shqiptare e Futbollit
<b>GLN</b>	Gazi i Lëngshëm i Naftës
<b>IAL</b>	Institucionet e Arsimit të Lartë
<b>ICN</b>	Rrjeti Ndërkombëtar i Konkurrencës
<b>IPA</b>	Instrumenti i Para-Zgjerimit i BE
<b>IDP</b>	Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale dhe informimit publik
<b>KE</b>	Komisioni Europian
<b>KESH</b>	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare
<b>Ligji nr. 9121/2003</b>	Ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar
<b>MEPJ</b>	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
<b>MFE</b>	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
<b>MIE</b>	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
<b>MSA</b>	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
<b>OECD</b>	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
<b>OECD-GVH/RCC</b>	Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik për Evropën Juglindore
<b>PKIE</b>	Plani Kombëtar për Integrimin Europian
<b>RSH</b>	Republika e Shqipërisë
<b>SFJB</b>	Shoqëri Financiare Jobankare
<b>TIA</b>	Tirana International Airport
<b>UK</b>	Ujësjetllës Kanalizime
<b>UNCTAD</b>	Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin



## **PJESA E PARË**

### **1.1 Zbatimi i rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë**

Në zbatim të rekomandimeve të dhëna me Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2022”, nr. 1094/2, datë 22.06.2023, AK ka realizuar veprimtarinë e tij në këto drejtime:

***1. Të veprojnë në kohën e duhur dhe me gjithë forcën e ligjit për ndëshkimin e operatorëve të tregut me sjellje të përseritur në shkëlqje të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg dhe me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqenien e konsumatorit.***

***AK ka përmbushur këtë rekomandim të dhënë sipas Rezolutës.***

Gjatë vitit 2023, AK ka vazhduar monitorime, hetime dhe vlerësime të tregjeve historike si: tregu i karburanteve, tregu i sigurimeve, tregu i telefonisë celulare etj.

***2. Të monitorojë sjelljen e ndërmarrjeve të prekura nga transaksioni i përqendrimit në tregun e telefonisë celulare në kushtet kur shtruktura e tregut ka ndryshuar tërësisht.***

***AK ka përmbushur këtë rekomandim të dhënë sipas Rezolutës.***

Në zbatim të kësaj pike, Autoriteti i Konkurrencës informon se puna për përmbushjen e kësaj pike të rezolutës ka vijuar si më poshtë.

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, nëpërmjet emaileve si edhe shkresave janë depozituar disa ankesa ndaj ndërmarrjes One Albania SHA dhe Vodafone Albania. Nisur nga këto ankesa, Autoriteti i Konkurrencës ka kërkuar informacion nga ndërmarrjet One Albania SHA dhe Vodafone Albania mbi problematikat e ngritura. Gjithashtu për vlerësimin e plotë të ankesave të depozituata, Autoriteti i Konkurrencës ka kërkuar informacion edhe nga AKEP. Autoriteti i Konkurrencës ka vlerësuar ankesat në bazë të informacionit dhe të dhënave të përpunuara, të cilat janë përfutur nga përgjigjet e ndërmarrjeve të tregut si edhe AKEP. Procesi i monitorimit të këtij tregu, nga Autoriteti i Konkurrencës vijon.
2. Nisur nga ankesat ndaj ndërmarrjes One Albania SHA si edhe në vijim të monitorimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 869, datë 08.03.2022 “Mbi përfitimin e kontrollit të shoqërisë ALBANIA TELECOM INVEST AD nga shoqëria 4IG NYILVANOSAN MUKODO RESZVENYTARSASAG”, Autoriteti i Konkurrencës i është drejtuar ndërmarrjes One Albania SHA duke kërkuar informacion. Nga përmbajtja e informacionit të depozituar nga ndërmarrja One Albania SHA, pranë Autoritetit të Konkurrencës, është evidentuar se problematikat e ngritura kanë ardhur si rezultat i implementimit të sistemeve të reja nga ana e ndërmarrjes One Albania SHA në kuadër të procesit të bashkimit me përthithje të ndërmarrjes

ALBtelecom SHA, dhe për këto arsye ankesat objekt vlerësimi nuk bien në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 9121 datë, 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

3. Autoriteti i Konkurrencës vijon me monitorimin e tregut të telefonisë celulare në zbatim të pikës III të dispozitivit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 869, datë 08.03.2022 “Mbi përfitimin e kontrollit të shoqërisë ALBANIA TELECOM INVEST AD nga shoqëria 4IG NYILVANOSAN MUKODO RESZVENYTARSASAG”.

**3. Të ndjekë përmbushjen e rekomandimeve të dhëna në tregjet e monitoruara apo të hetuara gjatë vitit 2022. Të vlerësojë rast pas rasti sjelljen e ndërmarrjeve, të cilat gëzojnë pozitë dominuese nëpërmjet marrëveshjeve koncesionare në fuqi apo atyre të reja, si: projekti i investimit strategjik “Marina dhe Jahtet e Durrësit”.**

**AK ka përmbushur këtë rekomandim të dhënë sipas Rezolutës.**

AK, në tregjet me pozitë dominuese/koncesionet, ka realizuar këto procedura:

- *Tregu i shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK;*

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 42 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, vendosi me Vendimin nr. 984, datë 11.5.2023 për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, për periudhën kohore nga 1 janar 2022 deri në 11 maj 2023.

Bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 9121/2003, Komisioni i Konkurrencës vlerësoi se mund të ishim përpara një rasti urgjence për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën në këtë treg, pasi kishte të ngjarë për shkelje të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003 dhe për këto arsye, me Vendimin nr. 987, datë 24.05.2023 “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës”, vendosi marrjen e masës së përkohshme ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK, për lejimin e aksesit pa kushte për të gjithë ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin taksi nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës dhe heqjen e tabelës me shkrimin “Ndalohet taksi pa pasagjerë”.

Në përfundim të procedurës së hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës vlerësoi se, ndërmarrja TIA ka zbatuar VKK nr. 987, datë 24.05.2023 “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës”.

Ndërmarrja Tirana International Airport SHPK është poseduese dhe administruese e vetme e infrastrukturës dhe faciliteteve të aeroporti ndërkombëtar të Tiranës, i cili për nga vet natyra është një facilitet esencial për kryerjen e transportit ajror.

Me vendosjen e tabelës me shkrimin “Ndalohet taksi pa pasagjerë”, vendosur në zonën e jashtme Kiss&Fly, ndërmarrja Tirana International Airport SHPK, nuk lejonte ofrimin e shërbimit taksi nga taksi të tjera që operojnë në treg, brenda territorit të Aeroportit ndërkombëtar të Tiranës, sjellje e cila në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, mund të përbënte abuzim me pozitën dominuese, duke refuzuar aksesin dhe ndërmarrjeve të tjera që janë të licencuara dhe që ofrojnë shërbimin e transportit rrugor të udhëtarëve me taksi nga aeroporti drejt Tiranës apo një destinacioni tjetër.

Për këto arsye me Vendimin nr. 1013, datë 13.09.2023, Komisioni i Konkurrencës vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK dhe ndërmarrjes Auto Holiday Albania SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës. Hetimi i thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2022 deri në 15 tetor 2023.

Procedurat hetimore kanë mbaruar, Komisioni i Konkurrencës ka realizuar senca dëgjimore me ndërmarrjet ne hetim dhe institucionet përkatëse dhe Komisioni i Konkurrencës është ne fazën e vendimmarrjes.

▪ *Tregu i menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Aeroportit “Nënë Tereza”*

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 921, datë 09.11.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të aeroportit “Nënë Tereza” (Tirana International Airport) dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK”, vendosi:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Aeroportit “Nënë Tereza” (Tirana International Airport).
- II. Gjybitjen e ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK në masën 1% të xhiros të vitit paraardhës financiar, përkatësisht në shumën 1,614,899 (një milion e gjashtëqind e katërmëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) Lekë.
- III. Miratimin e angazhimeve të depozituar nga ndërmarrja Star Parking Albania SHPK, si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve, si më poshtë vijon:
  - a) Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK të hartojë një metodologji për llogaritjen e kostove për formimin e çmimit të telepasit;
  - b) Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK të aplikojë tarifa të orientuara drejt kostos, për ndërmarrjet që pajisen me telepas si dhe për çdo shërbim tjetër;
  - c) Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK nuk do të zbatojë kushte të pabarabarta me ndërmarrjet të cilat lidhin kontratë me Star Parking për tu pajisur me telepas, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence.
- IV. Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK ka detyrimin të mos abuzojë me pozitën dominuese veçanërisht:

- a) vendosjen, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregimit;
  - b) kufizimin e prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik;
  - c) zbatimin e kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
  - d) vendosjen e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.
- V. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja Star Parking Albania SHPK në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohet me penalitetin përkatës.
- VI. Për përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në pikën III të këtij vendimi, ndërmarrja Star Parking Albania SHPK do të monitorohet për një periudhë 1 vjeçare.

Autoriteti i Konkurrencës është duke monitoruar dhe vlerësuar sjelljen e ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK, në zbatimin të vendimit të Komisionit të Konkurrencës.

▪ *Projekti i investimit strategjik “Marina dhe Jahtet e Durrësit”*

Me vendimin nr. 917, datë 24.10.2022 “Mbi disa rekomandime në lidhje me draft Marrëveshjen Kuadër për projektin e investimit strategjik “Marina dhe Jahtet e Durrësit” dhe marrëveshjeve të ktjera të dakortësuara ndërmjet komitetit të negociimit të marrëveshjeve dhe subjektit investues, Eagle Hills Real Estate Development shpk”, Komisioni i Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë që:

- i. Përpara se Porti Marina Jahte Durrës të deklarohet i hapur për trafik ndërkombëtar, të miratojë metodologjinë e përcaktimit të tarifave të shërbimeve portuale të ofruara nga Investitori Strategjik, tarifa të cila duhet të jenë të orientuara drejt kostos.
- ii. Investitori Strategjik të miratojë një rregullore mbi funksionimin e Portit Marina Jahte Durrës ku të përcaktojë qartë mënyrën e operimit të mjeteve lundruese sipas parimit “kush hyn i pari do shërbehet i pari”, si dhe të drejtën e barazisë për shoqëritë që do të kryejnë shërbime pranë këtij porti, duke vendosur kushte të barabarta për veprime tregtare të njëjta.
- iii. Investitori Strategjik të miratojë programe të përputhshmërisë me ligjin nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, për të gjitha shërbimet që do të ofrojë në Portin Marina Jahte Durrës.

Gjithashtu, Komisioni i Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) që brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjes së ndërmarrjes së përbashkët, Investitori Strategjik (JV), të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës, njoftimin në zbatim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sipas pkarashkimeve në draft Marrëveshjen Kuadër.

Me shkresën nr. 51 prot., i AK, datë 18.01.2023 “Njoftim në zbatim të pikës II të Vendimit nr. 917, datë 24.10.2022 të Komisionit të Konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës u njoftua në lidhje me



themelimin e një shoqërie të përbashkët (joint – venture) nga shoqëritë Eagle Hills Real Estate Development SHPK dhe Albanian Seaports Development Company SHA dhe miratimin e ligjit nr.79, datë 24.11.2022 “Për miratimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Eagle Hills Real Estate Development, Albanian Seaports Development Company SHA dhe NSHMI Development L.L.C., në lidhje me projektin e investimit strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit”.

Transaksioni i njoftuar ishte në përputhje në nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë u bë objekt kontrolli dhe autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Me vendimin nr. 971, datë 07.04.2023 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, nga shoqëritë Eagle Hills Real Estate Development SHPK dhe Albanian Seaports Development Company SHA”, Komisioni vendosi autorizimin e përqendrimit me detyrimin e shoqërisë Durrës Marina SHA, për të respektuar zbatimin e nenit 9 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, në tregun e shërbimit të marinës së jahteve.

***4. Të ndërmarrë një procedurë monitorimi apo hetimi në tregun e shërbimit spitalor privat, me qëllim vlerësimin e konkurrencës në këtë treg, në kushtet e ndryshimeve të pronësisë së spitaleve private gjatë viteve të fundit.***

***AK ka përmbushur këtë rekomandim të dhënë sipas Rezolutës.***

Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të rekomandimit të dhënë në Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2022” nga Kuvendi i Shqipërisë, me Urdhrin nr. 46, datë 24.10.2023 “Për ngritjen e grupit të punës “Për monitorimin e tregut të shërbimit spitalor privat””, ka filluar procedurën e monitorimit të këtij tregu.

Në kuadër të monitorimit, për të mbledhur informacion dhe për të adresuar problemet e duhura, grupi i punës ka realizuar një takim me përfaqësues të Qendrës Spitalore Universitare Tiranë.

Në zbatim të nenit 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të kërkuar informacion në lidhje me listën e spitaleve jopublike, gjithashtu i është drejtuar spitaleve jopublike për të marrë informacion mbi tarifatat për disa shërbime dhe paketat që këto spitale ofrojnë.

Autoriteti i Konkurrencës është duke vijuar monitorimin e këtij tregu.

***5. Të nxisë bashkëpunimin me Agjencinë e Prokurimit Publik për raportimin e rasteve të dyshuara në shkelje të konkurrencës dhe të jetë më proaktiv në zbulimin e marrëveshjeve të ndaluara në fushën e prokurimeve publike.***

***AK ka përmbushur këtë rekomandim të dhënë sipas Rezolutës.***

Autoriteti i Konkurrencës, në kuadër të përmbushjes së këtij rekomandimi dhe në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik dhe Komisionin e Prokurimit Publik, ka realizuar 1 (një) procedurë hetimore dhe 4 (katër) vlerësime ankesash në tregun e prokurimit publik.

- *Hetim në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK.*

Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) nëpërmjet shkresës nr. 1257/4 prot., datë 04.07.2023 (protokolluar pranë AK me nr. 373 prot., datë 06.07.2023), depozitoi Vendimin nr. 555/2023 prot., datë 04.07.2023, “Urdhër për pezullimin e shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë Li.Bo - Albania Branch SHPK me nr. 1250 prot., datë 31.05.2023 dhe Trakmar SHPK, me nr. 1257 prot., datë 01.06.2023”.

Nga vlerësimi i informacionit të paraqitur nga KPP, u ngritën dyshime të arsyeshme se mes ndërmarrjeve pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit të pajisjeve, instrumenteve, veglave elektrike dhe digjitale të zhvilluara nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA, ka elementë të një sjelljeje antikonkurrese, e cila mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1000, datë 17.07.2023, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK, për periudhën kohore nga 26 shtator 2022 deri në 17 korrik 2023.

Në përfundim të procedurës së hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës vlerësoi se bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet, që kanë si objekt, ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, si dhe Udhëzimin “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, sjellja e ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK, në tregun e prokurimit me objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, të zhvilluara nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA, ngrre dyshime për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet një marrëveshjeje të dyshimtë në oferta midis tyre.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 1026, datë 26.10.2023, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK për periudhën 26 shtator 2022 deri në 26 tetor 2023.

Procedurat hetimore kanë mbaruar, Komisioni i Konkurrencës ka realizuar senca dëgjimore me ndërmarrjet ne hetim dhe është në fazën e vendimmarrjes.

*Vlerësime ankesash në tregun e prokurimit publik;*

- *1 (një) rast referuar pranë AK nga Agjensia e Prokurimit Publik;*

Pranë Autoritetit të Konkurrencës me shkresën nr. 654 prot., datë 20.11.2023, Agjensia e Prokurimit Publik ka referuar rastin për dyshim mbi një marrëveshje të ndaluar në oferta në procedurën e prokurimit publik me objekt: Shërbim disinsektimi të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor Agjensia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

- *1 (një) rast referuar pranë AK nga Bashkia Mirditë;*

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, me shkresën nr. 658 prot., datë 21.11.2023 Bashkia Mirditë ka kërkuar sqarim lidhur me mënyrën e ofertimit të një operatori ekonomik në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt: “Inspektim teknik priodik, kolaudim i kaldajave, enëve nën presion, aktin teknik të montimit të pajisjeve si dhe miratimin e projektit teknologjik”.

- *1 (një) rast referuar pranë AK nga Agjensia e Blerjeve të Përqendruara;*

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, me shkresën nr. 667, datë 24.11.2023 Agjensia Shtetërore e Blerjeve të Përqendruara ka paraqitur një kërkesë për verifikim çmimesh për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale kancelarie”.

- *1 (një) rast referuar pranë AK nga Operator Ekonomik pjesëmarrës në procedurë prokurimi*

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, operatori ekonomik F.SH nëpërmjet emailit të datës 18.4.2023, (protokolluar pranë AK me nr. 239 prot., datë 18.4.2023), ka depozituar ankesën lidhur me një marrëveshje të dyshimtë në oferta midis operatorëve ekonomik pjesëmarrës në 13 procedurat e prokurimit në shërbimin e dezinfektimit.

Nga vlerësimi i ankesës, rezultoi se nuk kishte elementë të një sjelljeje antikonkurrese, e cila mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

***6. Të mbikqyrë me prioritet dhe të dalë me rekomandime konkrete për tregjet sensitive dhe me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqenien e konsumatorit shqiptar, si: tregu i prodhimit të qumështit dhe nënproduktet e tij, tregu i ushqimeve, sidomos artikujt bazë të shportës, tregu i karburanteve, tregu i materialeve të ndërtimit, etj.***

***AK ka përmbushur këtë rekomandim të dhënë sipas Rezolutës.***

Për zbatimin e këtij rekomandimi, AK, gjatë vitit 2023, ka realizuar monitorime dhe procedura hetimore në tregjet sensitive dhe me impakt të drejtpërdrejtë në mirëmbajtjen e konsumatorit:

- *15 (pesëmbëdhjetë) monitorime:*
  - *Tregu i prodhimit, grumbullimit dhe shitjes së grurit vendas;*
  - *Tregu i tregimit të produkteve ushqimore oriz dhe sheqer;*
  - *Tregu i prokurimit publik të shërbimeve të dezinfektimit;*

- *Tregu i transportit ndërkombëtar detar të udhëtareve dhe mjeteve për itinerarin Sarandë-Korfu-Sarandë;*
  - *Tregu i shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt aeroportit ndërkombëtar të Tiranës;*
  - *Tregu i aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës ;*
  - *Tregu i plehrave kimike: DAP, Nitrat URE;*
  - *Tregu i sigurimeve për produktin kartoni jeshil;*
  - *Tregu i sigurimeve për produktin TPL;*
  - *Tregu i menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Tirana International Airport;*
  - *Tregu i shërbimit të përgatitjes dhe pajisjes me leje drejtimi;*
  - *Tregu i shërbimeve celulare;*
  - *Tregu i tregimit të karburanteve;*
  - *Tregu i shërbimit spitalor;*
  - *Tregu i shërbimit të administrimit dhe mirëmbajtjes së ashensorëve pranë rezidencave të banimit të qarkut të Tiranës.*
- *8 (tetë) procedura hetimore:*
    - *Tregu i prodhimit/ importit dhe shitjes me shumicë të çimentos;*
    - *Tregu i prodhimit dhe tregimit të betonit në qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit;*
    - *Tregu i importit, prodhimit dhe tregimit me shumicë të vajit vegjetal;*
    - *Tregu i prokurimeve publike;*
    - *Tregu i prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë dixhitale të produkteve audio dhe video, tek operatorët kabllorë (ripërtëritësit e programeve mbështetur në rrjet kabllor) ndaj ndërmarjes Digitalb SHA.;*
    - *Tregu i prodhimit dhe tregimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit;*
    - *Tregu i aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës;*
    - *Tregu i shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt aeroportit ndërkombëtar të Tiranës.*

**7. Të vijojë përpjekjet për sigurimin e mbështetjes financiare për digjitalizimin e arkivës dhe protokollit të Autoritetit**

**AK ka përmbushur këtë rekomandim të dhënë sipas Rezolutës dhe është në pritje të miratimit të financimit.**

Ngritja e sistemit të menaxhimit të informacionit për Autoritetin e Konkurrencës ka qenë prioritet i institucionit që nga viti 2022.

Me shkresën nr. 279 prot., i AK datë 20.04.2022 “Kërkesë për zhvillim procedure” Autoriteti i Konkurrencës i ka kërkuar Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) realizimin e procedurës së prokurimit me objekt “Ngritja e sistemit të menaxhimit të informacionit për Autoritetin e Konkurrencës”, në përfundim të së cilës u hartuan Specifikimet Teknike nga personat përgjegjës, si dhe u përllogarit fondi për realizimin e këtij procesi.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit me shkresën nr. 8025 prot., datë 22.12.2022 ka kërkuar nga Autoriteti i Konkurrencës konfirmimin e fondeve për të vijuar me realizimin e procedurës.

Në buxhetin e miratuar për vitin 2023, Autoriteti i Konkurrencës nuk ka patur të miratuar fond investimesh për informatizimin e sistemit të menaxhimit të informacionit dhe për këtë arsye, me shkresën nr. 32 prot., datë 16.01.2023 “Mbi procedurën me objekt: “Ngritja e sistemit të menaxhimit të informacionit për Autoritetin e Konkurrencës” dhe shkresën nr. 32/2 prot., datë 21.09.2023 “Kthim përgjigje për procedurën e me objekt: “Ngritja e sistemit të menaxhimit të informacionit për Autoritetin e Konkurrencës”, ka kërkuar nga AKSHI mbështetje financiare për këtë projekt.

Në përgjigje të kërkesave, AKSHI informon se e ka të pamundur të parashikojë fonde për këtë projekt dhe se tavani buxhetor i vitit 2024 për art. 231 (investime), i caktuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë është i pamjaftueshëm.

Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr.170/9 prot., datë 01.09.2023 “Dërgohen kërkesat buxhetore shtesë dhe PBA 2024-2026, faza 2”, i ka kërkuar Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, që në zbatim të kërkesave të Kuvendit, si dhe në vijim të korrespondencës shkresore me AKSHI-n, të na miratojë nevojën për fonde buxhetore për projektin “Ngritja e sistemit të menaxhimit të informacionit për Autoritetin e Konkurrencës”, si më poshtë:

- Për vitin 2024 kërkohet një shtesë prej 228,059,184 lekë e cila ndahet në:
  - Vlerën e implementimit të projektit që është në shumën 174,059,784 lekë dhe
  - Vlerën e mirëmbajtjes që është në shumën 53,366,400 lekë
- Për vitet 2025 dhe 2026 kërkohen përkatësisht 53,366,400 lekë, si fond i nevojshme për mirëmbajtjen e sistemit.

Gjithashtu me shkresën nr.637 prot., datë 10.11.2023 “Kërkesë për shtesë në buxhetin e viteve 2024, 2025 dhe 2026 për Autoritetin e Konkurrencës”, i është kërkuar Kryetares së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Kryetarit të Komisionit për Ekonominë dhe Financat, që në miratimin e buxhetit të vitit 2024, Ministria e Financës dhe Ekonomisë të parashikojë fonde buxhetore, në zërin e investimeve, për Autoritetin e Konkurrencës, për të mbështetur projektin e menaxhimit të informacionit për Autoritetin e Konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës, në buxhetin e vitit 2024, nuk ka të miratuar fonde në zërin investime për të mbështetur projektin e menaxhimit të informacionit pranë AK.

***8. Të vijojë promovimin e kulturës së konkurrencës përmes intensifikimit të mardhënieve me botën Akadematike, strukturat e biznesit dhe institucionet e tjera publike dhe private për çështjet e rregullimit të tregut, mbarëvajtjes së konkurrencës dhe mirëqenies së konsumatorit***

***AK ka përmbushur këtë rekomandime të dhëna sipas Rezolutës.***

AK gjatë vitit 2023, në kuadër të promovimit të kulturës së konkurrencës, ka organizuar 5 aktivitete:

1. Autoriteti i Konkurrencës, në bashkëpunim me projektin SANECA të GIZ dhe UNDP Albania, më datë **23 nëntor 2023**, zhvilloi Konferencën Ndërkombëtare me temë “*20-vjetori i ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” në Shqipëri: Pavarësia dhe roli i autoritetit në reformën rregullatore, zbatimi i ligjit, advokacia dhe sfidat drejt Integritimit në Bashkimin Evropian*”. Në kuadër të promovimit të kulturës së konkurrencës dhe 20 vjetorit të rrugëtimit të Shqipërisë në mbrojtje të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, kjo konferencë mbledhi së bashku ekspertë të autoriteteve homologe nga rajoni dhe Evropa; përfaqësues nga pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor; organet rregullatore, përfaqësues nga dhomat e tregtisë, si dhe pjesëmarrës nga bota akademike dhe e biznesit
2. Autoriteti i Konkurrencës, në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, më datë **14 dhjetor 2023**, zhvilloi Workshop-in me temë “*Promovimi i mëtejshëm i kulturës së konkurrencës me botën akademike*”.
3. Autoriteti i Konkurrencës, në bashkëpunim me Shoqatën “Bashkimi Tregtar i Shqipërisë” më datë **6 qershor 2023** zhvilloi Workshop-in me Shoqatën “Bashkimi Tregtar i Shqipërisë” me temë “*Marrëveshjet në Oferta në Proçedurat e Prokurimit Publik në kuptim të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”*”.
4. Autoriteti i Konkurrencës, në bashkëpunim me Bashkinë Berat, më datë **22 shtator 2023** zhvilloi Workshop-in me temë “*Për rritjen e kulturës së konkurrencës dhe forcimin e bashkëpunimit me biznesin në procedurat e prokurimit publik në kuptim të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”*”.
5. Autoriteti i Konkurrencës, në bashkëpunim me shoqatat e biznesit, më datë **19 dhjetor 2023** zhvilloi Workshop-in me temë “*Korniza legislative/ligjore për mbrojtjen e konkurrencës dhe nevoja për një rol më aktiv të Autoritetit të Konkurrencës në fushën e biznesit*”.

**9. Të vijojë zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga PKIE (Plani Kombëtar i Integritimit Evropian) në drejtim të përafrimit të legjislacionit me direktivat europiane në fushën e konkurrencës.**

**AK ka përmbushur këtë rekomandim të dhënë sipas Rezolutës.**

Në kuadër të procesit të integritimit evropian të vendit, në datat 6, 7 dhe 8 mars 2023, u zhvillua në Bruksel, takimi “Bilateral Screening”, në të cilin Autoriteti i Konkurrencës (AK) - si lider i Kapitullit 8 “Politika e Konkurrencës”, u përfaqësua nga Kryetari i AK, Z. Denar Biba dhe përfaqësues të tjerë të institucionit. Pjesë e këtij takimi ishin dhe përfaqësues nga institucione të tjera pjesëmarrëse në kapitull, si Ndhima Shtetërore, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e

Kulturës dhe pjesëmarrës online nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

Takimi i 14-të i nën komitetit “Tregu i brendshëm dhe konkurrenca përfshirë mbrojtja konsumatore dhe shëndetësia” u zhvillua në 30 maj 2023 në Tiranë. AK paraqiti një raport të hollësishëm të aktivitetit të institucionit, lidhur me procesin e përafrimit të legjislacionit dhe nismat e parashikuara në të ardhmen, aktivitetet zbatuese dhe implementimin e ligjit si dhe rritjen dhe forcimin e kapaciteteve institucionale. Përfaqësuesit e BE-së vlerësuan ndërhyrjet në treg nëpërmjet rasteve hetimore dhe vendimmarrjen e KK, rekomandimet e dhëna për institucionet qendrore e ato rregullatore, si dhe procesin e përafrimit dhe plotësimit të legjislacionit.

Në zbatim të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2023-2025, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 990, datë 08.06.2023, ka miratuar Udhëzuesin "Mbi udhëzimet jozyrtare për sa i përket çështjeve të reja ose të pazgjdhura në lidhje me nenet 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" për raste individuale”, në përputhje me Njoftimin e Komisionit mbi udhëzimet jozyrtare për sa i përket çështjeve të reja ose të pazgjdhura në lidhje me nenet 101 dhe 102 të Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian për raste individuale (letra udhëzuese) (C (2022) 6925 final).

Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 1043, datë 29.12.2023, ka miratuar “Manuali i procedurave për sjelljet antikonkurrese”, në përputhje me Manualin e Procedurave të sjelljeve anti-konkurrese (Dokument i Komisionit European, Nëntor 2019).

Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 1040 datë 22.12.2023, ka miratuar Udhëzuesin "Mbi praktikat më të mira për zbulimin e informacionit në bazat e të dhënave, gjatë procedurave hetimore dhe të kontrollit të perqendrimeve të parashikuara në ligjin nr. 9121, datë 28.07.2023 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, në përputhje me Praktikrat më të mira për zbulimin e informacioneve në procedurat sipas neneve 101 dhe 102 të TFEU dhe sipas Rregullores së Perqendrimeve (2 Qershor 2015/Dokument i Komisionit European).

AK ka realizuar plotësisht Planin Kombëtar për Integrimin Evropian për vitin 2023.

***10. Të forcojë kapacitetet administrative nëpërmjet trajnimit të stafit me qëllim rritjen e cilësisë së monitorimit, inspektimit, hartimit të raporteve, analizave dhe mbrojtjes së vendimeve të Komisionit të Konkurrencës në të gjitha shkallët e gjyqësorit.***

***AK ka përmbushur këtë rekomandim të dhënë sipas Rezolutës.***

Gjatë veprimtarisë së vitit 2023, AK ka synuar forcimin e kapaciteteve administrative nëpërmjet trajnimit të stafit me qëllim rritjen e cilësisë së punës, si më poshtë vijon:

- Në kuadër të bashkëpunimit me **OECD - GVH/RCC** janë realizuar 4 seminare si më poshtë:
  1. Në datat 14 - 16 shkurt u zhvillua nga RCC seminari me temë “Kontrolli i perqendrimeve në situata të paparashikuara”, në Budapest, Hungari.
  2. Në datat 28 - 30 mars u zhvillua nga RCC seminari me temë “Të drejtat e pronësisë intelektuale dhe politikës së Konkurrencës: Miq apo Armiq?”, në Budapest, Hungari.

3. Në datat 19 - 21 shtator u zhvillua nga RCC seminari me temë “Advokacia e konkurrencës”, në Baku, Azerbajxhan.
4. Në datat 12 - 14 dhjetor u zhvillua RCC seminari me temë “Mjetet e zbulimit në inspektime”, në Budapest, Hungari.

– Në kuadër të bashkëpunimit me **ICN, OECD, KE, ABA, Instituti Joint Vienna, Sekretariati i Energjisë, OBT dhe Autoritete homologe**, janë organizuar aktivitete si më poshtë:

➤ *4 Konferenca:*

1. Në datën 10 Tetor u zhvillua nga Autoriteti i Konkurrencë së Republikës së Kosovës Konferenca me temë “Dita e Konkurrencës 2023: Përfitimet e konkurrencës së drejt në Kosovë”, në Prishtinë, Kosovë.
2. Në datat 18 - 20 tetor u zhvillua nga ICN në bashkëpunim me Komisionin Kombëtar Spanjoll të Tregjeve dhe Konkurrencës “Konferenca Vjetore 2023”, në Barcelonë, Spanjë.
3. Në datat 8 - 9 nëntor u zhvillua nga Autoriteti Portugez i Konkurrencës “Konferenca e VI-të e Lisbonës për të drejtën e konkurrencës dhe Ekonominë”, në Lisbonë, Portugali.
4. Në datat 16 - 18 nëntor u zhvillua nga Agjensia Gjeorgjiane e Konkurrencës “Konferenca e II-të Ndërkombëtare për Konkurrencën dhe të Drejtën e Konsumatorit”, në Tbilisi, Gjeorgji.

- *Forume:*

1. Në datën 20 prill u zhvillua nga Sekretariati i Energjisë “Forumi për Legjislacionin Evropian të Energjisë”, në Vienë, Austri.
2. Në datat 7 - 8 dhjetor u zhvillua nga OECD “Forumi Global i Konkurrencës”, në Paris, Francë.

- *Workshop-e dhe Seminar:*

1. Në datat 7 - 8 mars u zhvillua nga ICN, Workshop-i me temë “Zhvillimi dhe sfidat e zbatimit të politikës së konkurrencës në rastin e sjelljes së njëanshme”, në Tokio, Japoni.
2. Në datat 10 - 12 korrik u zhvillua nga Organizata Botërore e Tregëtisë Workshop-i me temë “Politikën e konkurrencës, tregëtisë dhe zhvillimit”, në Gjënevë, Zvicër.
3. Në datat 2 - 3 tetor u zhvillua nga Komisioni Evropian seminari me temë “Ndihma Shtetërore dhe Konkurrenca”, në Bruksel, Belgjikë.

- *Të tjera:*

1. Në datat 29- 31 mars u zhvillua nga ABA Takimi Pranveror mbi Legjislacionin Antitrust, në Washington, SHBA.
2. Në datat 20 – 24 shkurt u zhvillua nga Joint Vienna Institute dhe Fondi Ndërkombëtar Monetar, trajnimi me temë “Parashikimi i së adhmes (Nowcasting)”, në Vienë, Austri.

Në kuadër të bashkëpunimit me **CREESE**, janë organizuar 3 aktivitete si më poshtë:

- Në datat 24 qershor - 6 korrik u zhvillua nga Shkolla verore CREESE, Kursi me temë “Politikën




e konkurrencës dhe rregullore”, në Rodos, Greqi.

- Në datat 30 qershor - 3 korrik u zhvillua nga Shkolla verore CREESE, Kursi për juristë me temë “Roli i ekonomisë në zbatimin e ligjit të konkurrencës dhe praktika”, në Rodos, Greqi.
- Në datat 1 korrik - 5 korrik u zhvillua Programi ekzekutiv CALEP ”, në Rodos, Greqi.

## PJESA E DYTË

### ZBATIMI I LIGJIT TË KONKURENCËS

#### 2.1 Tregjet e monitoruara



AK, në zbatim të nenit 28 dhe 29/1 të ligjit nr. 9121/2003, ka vlerësuar në total 45 ankesa, nga të cilat 35 ankesa kanë qenë jashtë objektit të ligjit nr. 9121/2003 dhe 10 prej tyre kanë kaluar në procedura monitorimi/hetimi, të paraqitura si më poshtë:

#### 4 (katër) Tregje të monitoruara që nuk kanë kaluar në procedura hetimore

- *Tregu i prodhimit, grumbullimit dhe shitjes së grurit vendas*

Autoriteti i Konkurrencës realizoi monitorimin në tregun e prodhimit, grumbullimit dhe shitjes së grurit vendas. Me qëllim grumbullimin e informacionit për vlerësimin e plotë të situatës në tregun përkatës, u realizua monitorimi në terren në ndërmarrje importuese, prodhuese dhe tregtuese të grurit. Gjatë këtij monitorimi vlen të theksohet bashkëpunimi me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në kuadër të adresimit të disa problematikave të konstatuara gjatë monitorimit në terren.

- *Tregu i tregtimit të produkteve ushqimore oriz dhe sheqer*

AK realizoi monitorimin në tregun e tregtimit të produkteve ushqimore oriz dhe sheqer. Gjatë procedurës së monitorimit, me qëllim grumbullimin e informacionit për vlerësimin e plotë të situatës në tregun përkatës, u realizua monitorim pranë ndërmarrjeve importuese të orizit dhe sheqerit si dhe është kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mbi importet e realizuara për produktet oriz dhe sheqer sipas subjekteve importuese, për periudhën 1 janar 2022 –

31 korrik 2023. Nga monitorimi rezultoi se në tregun e tregtimit të produkteve oriz dhe sheqer nuk vihen re shenja të një sjellje të mundshme antikonkurruese nga ndërmarrjet që operojnë në këtë treg, në kuptim të nenit 4 dhe nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003.

- *Tregu i prokurimit publik të shërbimeve të dezinfektimit*

AK vlerësoi ankesën e depozituar nga operatori ekonomik F.SH mbi një marrëveshje potenciale të bashkërenduar ndaj disa ndërmarrjeve që operojnë në tregun e prokurimit publik të shërbimit të dezinfektimeve, e paraqitur, mbi ekzistencën ose jo të një marrëveshje të fshehtë në oferta. AK, pasi administroi informacionin nga ndërmarrjet të referuara në ankesë, konstatoi se në procedurën e prokurimit në shërbimin e dezinfektimit objekt ankese nuk ka elementë të një sjellje antikonkurruese, e cila mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003.

- *Tregu i transportit ndërkombëtar detar të udhëtareve dhe mjeteve për itinerarin Sarandë-Korfuz-Sarandë*

AK vlerësoi disa ankesa në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtareve dhe mjeteve për itinerarin Sarandë-Korfuz-Sarandë. AK kërkoi informacion pranë Portit Detar Sarandë SHA dhe në përfundim të vlerësimit të ankesave rezultoi se asnjë nga veprimet apo mosveprimet e listuara në ankesat objekt vlerësimi, nuk bien në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9121/2003, duke u karakterizuar si një marrëveshje e ndaluar në kuptim të nenit 4, apo abuzim me pozitën dominuese në kuptim të nenit 9.

## **2 (dy ) Tregje të monitoruara dhe të kaluara në procedurë hetimore**

- *Tregu i shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt aeroportit ndërkombëtar të Tiranës*

AK monitoroi tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës. Nga vlerësimi i informacionit gjatë monitorimit të tregut të shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, u konstata se, në zonën e jashtme të mbërritjeve (ose ndryshe zona Kiss&Fly) e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, nëpërmjet një tabele me shkrimin “Ndalohet taksi pa pasagjerë”, nuk lejohet akses nga ndërmarrje të tjera të ofrojnë shërbimin e taksive për udhëtarë nga aeroporti drejt Tiranës të cilët nuk kanë pasagjerë brenda. Ky akses lejohet vetëm për taksitë e ndërmarrjes Auto Holiday Albania, ka çuar në dyshimet se mund të jemi para shkeljes së nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003.

KK, me vendimin nr. 984, datë 11.05.2023 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt aeroportit ndërkombëtar të Tiranës”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në këtë treg.

- *Tregu i aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës*

Nisur nga disa ankesa të depozituara pranë AK, mbi problematikat në zgjedhjen e ofrimit të shërbimit të internetit pranë disa komplekseve të pallateve Tiranë, bazuar në nenin 28, germa (a), të ligjit nr. 9121/2003, grupi i punës realizoi monitorimin pranë disa komplekseve të pallateve në Tiranë.

Nga vlerësimi i informacionit të grumbulluar gjatë monitorimeve të kryera pranë komplekseve të pallateve në Tiranë, rezultoi se, në disa komplekse, banorët dhe bizneset nuk kanë mundësi zgjedhje për shërbimin e internetit dhe mundësia e ofrimit është vetëm një ndërmarrje, duke çuar në dyshime të arsyeshme se në tregun e aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës, ka problematika dhe mund të ketë elementë të abuzimit me pozitën dominuese nga ndërmarrjet e administrimit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës, e cila mund të përbëjë shenja të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës në kuptim të nenit 9, të ligjit nr. 9121/2003.

Për këto arsye, KK me vendimin nr. 1025, datë 13.10.2023 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjeve të administrimit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës në tregun e aksesit të shërbimit të internetit, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në këtë treg.

## **6 (gjashtë) Tregje të monitoruara në zbatim të VKK 2022 dhe 2023**

- *Tregu i plehrave kimike: DAP, Nitrat URE*

Në zbatim të vendimit të KK nr. 874, datë 25.03.2022, bazuar në nenin 28, gërmës (d) të ligjit nr. 9121/2003, AK monitoroi për një vit tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure, për ndërmarrjet AGROBLEND SHPK, MBM SHPK, dhe ÇAÇA SHPK. Bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121/2003, u administrua informacioni i kërkuar nga ndërmarrjet: AGROBLEND SHPK, MBM SHPK, ÇAÇA SHPK dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Nga monitorimi u konstatua se sjellja e ndërmarrjeve Agroblend SHPK, MBM SHPK dhe ÇAÇA SHPK nuk përbënte shkelje në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003.

Për këto arsye, KK me anë të vendimit nr. 989, datë 08.06.2023, vendosi mbylljen e monitorimit në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure.

- *Tregu i sigurimeve për produktin kartoni jeshil*

KK, me vendimin nr. 904, datë 29.07.2022 “Për vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil”, vendosi përjashtimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes ndërmarrjeve të sigurimit lidhur me shitjen dhe administrimin

e Kartonit Jeshil për një periudhë 2 (dy) vjeçare me kushte dhe detyrime. AK do të monitorojë zbatimin e këtij vendimit duke bashkëpunuar me AMF dhe BSHS deri në përfundim të marrëveshjes së përjashtuar me kushte dhe detyrime.

- *Tregu i sigurimeve për produktin TPL*

KK, me vendimin nr. 751, datë 26.11.2020 “Për vlerësimin ligjor mbi përputhshmërinë me ligjin dhe rregulloret e “Marrëveshjes së bashkëpunimit “Ndërmjet shoqërive të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të pronarit të mjetit motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”, vendosi që marrëveshja e bashkëpunimit, për nga objekti dhe qëllimi, është në përputhje me ligjin nr. 9121/2003 dhe me nenin 3 të rregullores “Për zbatimin e nenit 6 të ligjit nr. 9121/2003 ndaj disa kategorive të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve”.

AK gjatë periudhës së monitorimit të zbatimit të VKK nr. 751/2020 ka bashkëpunuar me BSHS dhe ndërmarrjet e sigurimit. BSHS ka depozituar pranë AK, shkresën mbi të cilën jemi njoftuar për nevojën e vijimit të marrëveshjes aktuale edhe për 2 (dy) vite të tjera.

Nga vlerësimi i informacionit të depozituar, AK ka njoftuar BSHS se do të vijojë me monitorimin e zbatimit të “Marrëveshjes së bashkëpunimit “Ndërmjet shoqërive të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të pronarit të mjetit motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta””, nga periudha 26.11.2022 deri në 26.11.2025.

- *Tregu i menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Tirana International Airport*

KK, me vendimin nr. 921, datë 09.11.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të aeroportit “Nënë Tereza” (TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT) dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK”, vendosi mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në këtë treg, gjorbitjen e ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK, miratimin e angazhimeve të depozituara nga ndërmarrja të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve, si dhe detyrimin e ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK për të mos abuzuar me pozitën dominuese.

Në vijim të monitorimit, AK është duke vlerësuar informacionin e depozituar nga ndërmarrja Star Parking Albania SHPK.

- *Tregu i shërbimit të përgatitjes dhe pajisjes me leje drejtimi*

AK, nisur nga njoftimi i bërë në median e shkruar më datë 21 shkurt 2023, për një marrëveshje ndërmjet Grupeve të interesit përfaqësues të autoshkollave (Shoqata “Kombëtare e Autoshkollave” dhe Shoqata e Autoshkollave “Siguria në rrugë”), Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT-së) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR-së), në lidhje me

përcaktimin e kostos minimale fiskale (tarifat e pagesës) së përgatitjes për drejtues mjete, bazuar në nenin 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121/2003, ka filluar procedurat e vlerësimit të kësaj marrëveshje.

Nga vlerësimi paraprak i Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, rezultoi se, në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003, Akt Marrëveshja nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, nënshkruar ndërmjet grupeve të interesit përfaqësues të Autoshkollave, DPT-së dhe DPSHTRR-së, e cila përcakton tarifat e pagesës dhe koston referuese minimale fiskale për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimi, mund të ketë elementë të kufizimit të konkurrencës.

Në respektim të nenit 44 të ligjit nr. 9121/2003, KK vlerësoi se jemi përpara një rasti urgjence, pasi Akt Marrëveshja për përcaktimin e tarifës së pagesës dhe kostos minimale fiskale për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimi, nëpërmjet përcaktimit të tarifës minimale ka rrezik të sjell një dëm të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën në ofrimin e këtyre shërbimeve, duke reduktuar seriozisht përfitimet që tregjet konkurruese ofrojnë për konsumatorët.

KK, me Vendimin nr. 964, datë 01.03.2023, “Për marrjen e masave të përkohshme për ndalimin e zbatimit të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, në lidhje me përcaktimin e tarifës së pagesës dhe kostos minimale fiskale për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimi”, vendosi:

- I. Marrjen e masave të përkohshme ndaj palëve nënshkruese të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023: Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Shoqatës “Kombëtare të Autoshkollave”, Shoqatës së Autoshkollave “Siguria në rrugë” dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si vijon:
  1. Ndalimin e zbatimit të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, në lidhje me përcaktimin e tarifës së pagesës dhe kostos minimale fiskale për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimi;
- II. Depozitimin pranë AK-së të të gjithë praktikës së ndjekur deri në nënshkrimin e kësaj Akt Marrëveshjeje, për të kryer vlerësimin ligjor të saj, bazuar në nenin 4, nenin 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”;  
Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës administrative dhe marrjen e vendimit përfundimtar të Komisionit të Konkurrencës.
- III. Moszbatimi i këtij vendimi përbën shkelje të rëndë të konkurrencës në kuptim të nenit 74, pika 1, germa (b), të Ligjit nr. 9121/2003.

Në vijim të procedurës së vlerësimit të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, bazuar në VKK nr. 964, datë 01.03.2023, në zbatim të nenit 39 “E drejta e palëve për t'u dëgjuar”, të ligjit nr. 9121/2003, më datë 17.03.2023 KK zhvilloi seancën dëgjimore me përfaqësues të: DPSHTRR-së, DPT-së, Shoqatës “Kombëtare të Autoshkollave”, si dhe Shoqatës së Autoshkollave “Siguria në rrugë”, lidhur me Akt Marrëveshjen nr. 2729 prot., datë 13.02.2023.

Në vijim të seancës dëgjimore, në përmbushje të pikës II të VKK nr. 964/2023, nga DPSHTRR, nëpërmjet shkresës nr. 3532/3 prot., datë 16.03.2023, është depozituar pranë AK-së praktika shkresore e ndjekur deri në nënshkrimin e Akt Marrëveshjeje nr. 2729 prot., datë 13.02.2023.

Në përfundim të procedurës së vlerësimit të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, si

dhe kuadrit ligjor dhe nënligjor përkatës, bazuar në nenet 4, 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121/2003, rezultoi se: Akt Marrëveshja nr.2729 prot., datë 13.02.2023, lidhur ndërmjet grupeve të interesit përfaqësues të Autoshkollave, DPSHTRR-së dhe DPT-së, e cila ka për objekt *de facto* dhe *de jure* caktimin e tarifës së pagesës dhe kostos referuese minimale fiskale për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimi, sipas kategorisë së lejedrejtitimit, dëshmisë ose çertifikatës, është një marrëveshje e ndaluar në vetvete për nga objekti, në kuptim të nenit 4, pika 1, gërma (a), të ligjit nr. 9121/2003, pasi me hyrjen në fuqi do të çojë në praktika të njëjta në çmimet/tarifat e pagesës për përgatitjen dhe fitimin e kategorisë së leje drejtitimit, dëshmisë ose çertifikatës, duke penguar, kufizuar dhe shtrembëruar konkurrencën në treg. Si e tillë kjo Akt Marrëveshje, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 9121/2003, është e ndaluar.

Bazuar sa më sipër, KK, me vendimin nr. 970, datë 24.03.2023, “Mbi vlerësimin ligjor të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, të lidhur ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Shoqatës “Kombëtare të Autoshkollave”, Shoqatës së Autoshkollave “Siguria në rrugë” dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”, vendosi:

- I. Akt Marrëveshja nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, e lidhur ndërmjet palëve: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Shoqata “Kombëtare e Autoshkollave”, Shoqata e Autoshkollave “Siguria në rrugë” dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, vlerësohet si një akt marrëveshje në kundërshtim me nenin 4 të ligjit nr. 9121.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
- II. Monitorimin e tregut të shërbimit të përgatitjes dhe pajisjes me leje drejtimi, sipas kategorisë së lejedrejtitimit, dëshmisë ose çertifikatës, për një periudhë 1 (një) vjeçare.
- III. Moszbatimi i këtij vendimi përbën shkelje të rëndë të konkurrencës në kuptim të nenit 74, pika 1, gërma (c), të ligjit nr. 9121/2003.

Në zbatim të pikës II të vendimit nr. 970, datë 24.03.2023 “Mbi vlerësimin ligjor të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, të lidhur ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Shoqatës “Kombëtare të Autoshkollave”, Shoqatës së Autoshkollave “Siguria në rrugë” dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”, AK ka nisur procedurat për monitorimin e tregut të shërbimit të përgatitjes dhe pajisjes me leje drejtimi, sipas kategorisë së lejedrejtitimit, dëshmisë ose çertifikatës, për një periudhë 1 (një) vjeçare.

Monitorimi përfshin periudhën kohore nga 24 mars 2023 deri më 24 mars 2024, dhe është në proces.

- *Tregu i shërbimeve celulare*

KK, me vendimin nr. 869, datë 08.03.2022, “Mbi përfitim të kontrollit të shoqërisë ALBANIA TELECOM INVEST AD nga shoqëria 4IG NYILVANOSAN MUKODO RESZVENYTARSASAG”, vendosi disa detyrime ndaj ndërmarrjes 4iG Nyrtr, i dha disa rekomandime Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare si dhe vendosi për monitorimin e zbatimit të detyrimeve ndaj ndërmarrjes 4IG NYILVANOSAN MUKODO RESZVENYTARSASAG për një periudhë 2 (dy) vjeçare.

Monitorimi përfshin periudhën kohore 08 mars 2022 deri në 08 mars 2024 dhe është në proces.

### **3 (tre) Monitorime në vazhdim:**

#### *- Tregu i tregimit të karburanteve*

AK, në kuadër të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2022”, nëpërmjet të cilit i kërkuar Autoritetit “Të mbikëqyrë me prioritet dhe të dalë me rekomandime konkrete për tregjet sensitive dhe me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqenien e konsumatorit shqiptar si: tregu i karburanteve, etj., AK në zbatim të nenit 28, pika “a” të ligjit nr. 9121/2003, që pak kohë pas shfuqizimit të Bordit të Transparencës ka nisur procedurën e monitorimit të tregut të karburanteve, duke analizuar kushtet e tregut, për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive.

Autoriteti i Konkurrencës është duke vijuar monitorimin e këtij tregu.

#### *- Tregu i shërbimit spitalor*

AK, në zbatim të rekomandimit të dhënë në Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2022” nga Kuvendi i Shqipërisë, me Urdhrin nr. 46, datë 24.10.2023 “Për ngritjen e grupit të punës “Për monitorimin e tregut të shërbimit spitalor privat”, ka filluar procedurën e monitorimit të këtij tregu.

Në kuadër të monitorimit, për të mbledhur informacion dhe për të adresuar problemet e duhura, grupi i punës ka realizuar një takim me përfaqësues të Qendrës Spitalore Universitare Tiranë.

Në zbatim të nenit 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121/2003, AK i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të kërkuar informacion në lidhje me listën e spitaleve jopublike, gjithashtu i është drejtuar spitaleve jopublike për të marrë informacion mbi tarifatat për disa shërbime dhe paketat që këto spitale ofrojnë.

Autoriteti i Konkurrencës është duke vijuar monitorimin e këtij tregu.

#### *- Tregu i shërbimit të administrimit dhe mirëmbajtjes së ashensorëve pranë rezidencave të banimit të qarkut të Tiranës*

AK, bazuar në nenin 28, pika “a” të ligjit nr. 9121/2003, ka filluar procedurën e monitorimit të tregut të shërbimit të administrimit dhe mirëmbajtjes së ashensorëve pranë rezidencave të banimit të qarkut të Tiranës. Në kuadër të monitorimit dhe në zbatim të nenit 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121/2003, AK i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për të identifikuar ndërmarrjet që operojnë në treg, Inspektoriatit Shtetëror të Mbikëqyrjes së tregut duke kërkuar listën e ndërmarrjeve që realizojnë mirëmbajtjen dhe furnizimet e produktit ashensorë si dhe gjithashtu i është drejtuar dhe disa ndërmarrjeve duke kërkuar informacion mbi markat e tregtuara; pasja ose jo e ekzkluzivitetin në importin, instalimin apo mirëmbajtjen e ashensorëve të këtyre markave; kontratat e lidhura me subjekte/klientë dhe shërbimet e ofruara prej tyre.

Autoriteti i Konkurrencës është duke vijuar monitorimin e këtij tregu.

### **2.2 Marrëveshjet e ndaluara**



## MARRËVESHJET E NDALUARA

- *Tregu i prodhimit/ importit dhe shitjes me shumicë të çimentos.*
- *Tregu i prodhimit dhe tregtimit të betonit në qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit*
- *Tregu i importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal*
- *Tregu i prokurimeve publike*

- *Tregu i prodhimit/ importit dhe shitjes me shumicë të çimentos*

KK, me vendimin nr. 895, datë 05.07.2022 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos”, vendosi hapjen e hetimit paraprak në këtë për të vlerësuar nëse ka shenja të kufizimit të konkurrencës, sipas parashikimeve të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003. Hetimi paraprak përfshin periudhën kohore 1 janar 2021 deri në 30 qershor 2022. Në përfundim të analizës së realizuar gjatë periudhës hetimore u konstatuan elementë të cilët mund të përbëjnë shkelje të konkurrencës në kuptim të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 dhe për këto arsye, KK me vendimin nr. 969, datë 24.03.2023 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri dhe të bardhë”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri dhe të bardhë për periudhën kohore nga 1 janari 2019 deri në 31 mars 2023.

KK është në proces vendimarrje dhe do të vijojë me procedurat në kuptim të nenit 39 të ligjit 9121/2003.

- *Tregu i prodhimit dhe tregtimit të betonit në qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit*

KK, me vendimin nr. 913, datë 06.10.2022, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të betonit në qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të betonit, për të vlerësuar nëse ka shenja të kufizimit të konkurrencës, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9121/2003, për periudhën kohore 1 janar 2020 deri në 30 shtator 2022.

Në përfundim të hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të betonit në qarkun e Tiranës,

Durrësit dhe Elbasanit konstatohet se: Pjesët e tregut të ndërmarrjeve janë të ndryshueshme nga viti në vit, pra nuk vërehet qëndrueshmëri në pjesët e tregut sipas sasisë dhe ka hyrje të reja në treg, duke zotëruar pjesë të konsiderueshme tregu për një periudhë të shkurtër si dhe çmimet mesatare mujore të e aplikuar nga ndërmarrjet për produktin beton, për të gjitha markat janë të ndryshme nga njëra-tjetra dhe ritmi i ndryshimit të tyre është i ndryshëm, duke mos vërejtur shenja të caktimit të çmimeve apo koordinimit të tyre në ritmin e rritjes apo të zbritjes në kuptim të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr.9121/2003.

KK, me vendimin nr. 976, datë 14.04.2023 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të betonit në qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit”, vendosi mbylljen e këtij hetimi.

- *Tregu i importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal*

Gjatë procedurës së hetimit të thelluar u konstua se ndërmarrjet objekt hetimi nuk kanë aplikuar çmime të njëjta të shitjes me shumicë të vajit vegjetal, nuk kanë ndryshuar në të njëjtën masë dhe në të njëjtën kohë çmimet e shitjes dhe për këto arsye KK, me vendimin nr. 975, datë 14.04.2023 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve AGRO BLEND SHPK, BOMIRA SHPK, DEVI 20 - GRUP SHPK, EQEREM-934 SHPK, FERRA & CO SHPK, GLOBCOM SHPK, KRIKET-1 SHPK, TEUTA DURRES SHPK DHE PDF SHPK në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal”, vendosi për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve AGRO BLEND SHPK, BOMIRA SHPK, DEVI 20 - GRUP SHPK, EQEREM-934 SHPK, FERRA & CO SHPK, GLOBCOM SHPK, KRIKET-1 SHPK, TEUTA DURRES SHPK DHE PDF SHPK në këtë treg.

- *Tregu i prokurimeve publike*

Pranë AK, Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) ka depozituar Vendimin nr. 555/2023 prot., datë 04.07.2023, “Urdhër për pezullimin e shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë LI.BO-Albania Branch SHPK me nr.1250 prot., datë 31.05.2023 dhe Trakmar SHPK, me nr.1257 prot., datë 01.06.2023”.

KPP, nëpërmjet vendimit nr. 555/2023 ka vendosur:

- a) Të pezullojë shqyrtimin administrativ të operatorëve ekonomikë LI.BO-Albania Branch SHPK me nr. 1250 prot., datë 31.05.2023 dhe TrakMar SHPK me nr. 1257 prot., datë 01.06.2023 për procedurën e prokurimit “objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe dixhitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe

DCVG)”, me fondin limit 4,854,422 lekë pa TVSH që është zhvilluar në datë 05.05.2023 nga Autoriteti Kontraktor, Albanian Gas Services Company SHA.

- b) T’i kërkojë Autoritetit të Konkurrencës fillimin e procedurës së hetimit administrativ lidhur me konstatimet e mësipërme dhe të informojë KPP në përfundim të hetimit mbi rezultatet e tij.

Nga vlerësimi i informacionit të paraqitur nga KPP, nëpërmjet vendimit nr. 555/2023, mbi shkeljet e pretenduara të konkurrencës nga ndërmarrjet LI.BO-Albania Branch SHPK dhe Raimondo G.P SHPK në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe dixhitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor, Albanian Gas Services Company SHA, ngrihen dyshime të arsyeshme se ndërmarrjet Raimondo G.P SHPK dhe LI.BO-Albania Branch SHPK përdorin skemën e ofertës së mbuluar duke rënë dakord më përpara se cili prej tyre do të paraqesë ofertën më të lartë dhe cili ofertën fituese në procedurën e prokurimit ku ata do të jenë pjesëmarrës, me qëllim që të kualifikohet ai që ka ofertën më të ulët, duke krijuar përshtypjen e një oferte të pastër dhe një konkurrence të sigurtë.

Gjithashtu ngrihen dyshime të arsyeshme se mes ndërmarrjeve pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit të pajisjeve, instrumenteve, veglave elektrike dhe dixhitale të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor, Albanian Gas Services Company SHA, ka elementë të një sjelljeje antikonkurrese, e cila mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003

Për sa më sipër, KK me vendimin nr. 1000, datë 17. 07.2023 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në këtë treg.

Në përfundim të procedurës së hetimit paraprak, KK vlerësoi se bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121/2003, sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet, që kanë si objekt, ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, si dhe Udhëzimin “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, sjellja e ndërmarrjeve: Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK, në tregun e prokurimit me objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, të zhvilluara nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA, hedh dyshime për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet një marrëveshjeje të dyshimtë në oferta midis tyre.

Për këto arsye, KK me vendimin nr. 1026, datë 26.10.2023 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK.

Në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 9121/2003 ndërmarrjet objekt hetimit janë ftuar në një seancë dëgjimore për tu dëgjuar përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga KK.

### 2.3 Abuzimi me pozitën dominuese

## ABUZIMI ME POZITËN DOMINUESE

- *Tregu i prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë dixhitale të produkteve audio dhe video, tek operatorët kabllorë (ripërtëritësit e programeve mbështetur në rrjet kabllor) ndaj ndërmarrjes Digitalb SHA.*
- *Tregu i prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit*
- *Tregu i aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës*
- *Tregu i shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt aeroportit ndërkombëtar të Tiranës*

- *Tregu i prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë dixhitale të produkteve audio dhe video, tek operatorët kabllorë (ripërtëritësit e programeve mbështetur në rrjet kabllor) ndaj ndërmarrjes Digitalb SHA.*

KK, me vendimin nr. 940, datë 27.12.2022 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë dixhitale të produkteve audio dhe video, tek operatorët kabllorë(ripërtëritësit e programeve mbështetur në rrjet kabllor) ndaj ndërmarrjes Digitalb SHA, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Digitalb SHA për periudhën kohore nga 1 janar 2020 deri në 31 dhjetor 2022, për të parë nëse ka shkelje të nenit 4 dhe 9, të ligjit nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Përpara vendimarrjes KK realizoi një takim me Autoritetin e Mediave Audiovizive, si rregullator i këtij tregu.

KK, me vendimin nr.1014, datë 21.09.2023 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë dixhitale të produkteve audio dhe video, tek operatorët kabllorë (ripërtëritësit e programeve mbështetur në rrjet kabllor) ndaj ndërmarrjes Digitalb SHA, vendosi mbylljen e këtij hetimi si dhe detyrimin e të gjithë operatorëve OSHMA

audiovizive, si operatorë me pozitë dominuese, që t'ju japin të drejtën e ritransmetimit të programeve të tyre të gjithë operatorëve të interesuar, në çdo segment tregu.

- *Tregu i prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit*

KK, me vendimin nr. 961, datë 28.02.2023 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit” vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në këtë treg për periudhën janar 2021 – shtator 2022. Përpara vendimarrjes KK realizoi një takim me përfaqësues të MZHBR dhe AKU për problematikat e konstatuara në këtë treg.

Referuar analizës së tregut të prodhimit dhe shitjes me shumicë të nënprodukteve të qumështit, rezulton se sjellja e ndërmarrjeve me pjesë të konsiderueshme tregu, Erzeni SHPK, Gjirofarma SHA, ADG SHPK (Lufra), SHAKA Boboshticë SHPK, mund të përbëjë abuzim me pozitë dominuese sipas nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003.

Për këto arsye, KK me vendimin nr. 1045, datë 29.12.2023 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve Erzeni SHPK, Gjirofarma SHA, ADG SHPK (Lufra), SHAKA Boboshticë SHPK në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit” vendosi hapjen e hetimit të thelluar në këtë treg. Hetimi do të përfshijë periudhën 1 janar 2022- 31 dhjetor 2023.

- *Tregu i aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës*

Nisur nga disa ankesa të depozituara pranë AK, mbi problematikat në zgjedhjen e ofrimit të shërbimit të internetit pranë disa komplekseve të pallateve Tiranë, bazuar në nenin 28, germa (a), të ligjit nr. 9121/2003, AK realizoi monitorimin pranë disa komplekseve të pallateve në Tiranë.

Mbështetur në gjëttjet e monitorimit, KK me vendimin nr. 1025, datë 13.10.2023 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjeve të administrimit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës në tregun e aksesit të shërbimit të internetit, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në këtë treg. Hetimi përfshin periudhën kohore nga 01.01.2020 deri në 13.10.2023, dhe është në proces.

- *Tregu i shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt aeroportit ndërkombëtar të Tiranës*

Sekretariati i AK bazuar në nenin 28, germa (a), të ligjit nr. 9121/2003, ka monitoruar tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës.

Nga vlerësimi i informacionit gjatë monitorimit të tregut të shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, u konstatua se, në zonën e jashtme të mbërritjeve (ose ndryshe zona Kiss&Fly) e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, nëpërmjet një table me shkrimin “Ndalohet taksi pa pasagjerë”, nuk lejohet aksesi nga ndërmarrje të tjera të ofrojnë shërbimin e

taksive për udhëtarë nga aeroporti drejt Tiranës të cilët nuk kanë pasagjerë brenda. Ky akses lejohet vetëm për taksitë e ndërmarrjes Auto Holiday Albania, duke çuar në dyshimet se mund të jemi para shkeljes së nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003.

KK, me vendimin nr. 984, datë 11.05.2023 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt aeroportit ndërkombëtar të Tiranës”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në këtë treg.

Bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 9121/2003, referuar sjelljes se ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, u vlerësua se mund të jemi përpara një rasti urgjence për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën në këtë treg, pasi ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003.

Për sa më sipër, KK me vendimin nr. 987, datë 24.05.2023 “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt aeroportit ndërkombëtar të Tiranës”, vendosi:

- I. Marrjen e masës së përkohshme ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, si vijon:
  - a. Lejimin e aksesit pa kushte për të gjithë ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin taksi nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës.
  - b. Të heqë tabelën me shkrimin “Ndalohe taksi pa pasagjerë”, e cila ndalon dhënien e këtij shërbimi në shkelje të ligjit nr. 9121/2003.

Në përfundim të procedurës së hetimit paraprak, u konstatua se, pavarësisht se ndërmarrja TIA ka zbatuar VKK nr. 987, datë 24.05.2023 “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës”, fakti që deri në momentin e konstatimit nga Autoriteti i Konkurrencës ndërmarrja Tirana International Airport SHPK ka vendosur në zonën e jashtme të mbërritjeve (ose ndryshe zona Kiss&Fly) tabelën me shkrimin “Ndalohe taksi pa pasagjerë”, si dhe nuk ka lejuar ofrimin e shërbimit dhe taksive të tjera që operojnë në treg, brenda territorit të Aeroportit ndërkombëtar të Tiranës, i cili për nga vet natyra është një facilitet esencial për kryerjen e transportit ajror si dhe kjo ndërmarrje është poseduese dhe administuese e vetme e infrastrukturës dhe faciliteteve të aeroporti ndërkombëtar të Tiranës, duke zotëruar 100% të pjesëve të tregut përkatës, në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sjellja e TIA mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese duke refuzuar aksesin dhe ndërmarrjeve të tjera që janë të licensuara dhe që ofrojnë shërbimin e transportit rrugor të udhëtarëve me taksi nga aeroporti drejt Tiranës apo një destinacioni tjetër.

Për sa më sipër, KK me vendimin nr. 1013, datë 13.09.2023 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK dhe ndërmarrjes Auto Holiday Albania SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të

Tiranës”, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK dhe ndërmarrjes Auto Holiday Albania SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës.

Ndërmarrjet Tirana International Airport SHPK dhe Auto Holiday Albania SHPK janë ftuar pranë AK në një seancë dëgjimore për tu dëgjuar përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga KK.

## 2.4 Përjashtim nga ndalimi i marrëveshjeve

- *Shtyrja e afatit të përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërive PHILIP MORRIS PRODUCTS S.A dhe KT&G CORPORATION.*

KK, me vendimin nr. 786, datë 25.03.2021 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërive Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation”, vendosi të përjashtonte nga ndalimi Marrëveshjen e Distribucionit ndërmjet palëve Philip Morris Products S.A ( PMI) dhe KT&G Corporation (KT&G) për një periudhë 2 vjeçare nga marrja e vendimit.

Në përfundim të periudhës së përjashtimit dhe në zbatim të nenit 50 “Vendimi për përjashtime individuale”, pika 4 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, palët në marrëveshje njoftuan për zgjatjen e Përjashtimit Individual të marrëveshjes.

AK konstatoi se hedhja në treg e produkteve KT&G në tregun shqiptar nga PMI nuk solli ndonjë efekt negativ në hyrjen apo rritjen e konkurrentëve aktualë apo potencialë në Shqipëri.

Për këto arsye, KK me vendimin nr.966, datë 17.03.2023, “Për shtyrjen e afatit të përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërive PHILIP MORRIS PRODUCTS S.A dhe KT&G CORPORATION”, vendosi të shtyjë afatin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërive Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation, deri në datë 26 tetor 2023.

- *Përjashtimi nga ndalimi i marrëveshjeve të lidhura ndërmjet shoqërive Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation*

Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pranë AK u depozitua kërkesa për përjashtimin nga ndalimi për “Marrëveshjen Kuadër për Tregtimin dhe Licencën e Teknologjisë”, “Marrëveshjen për Licencën e Markës Tregtare” dhe “Marrëveshjen e Shërbimit për Furnizimin dhe Logjistikën”, të nënshkuara në datë 30 janar 2023 ndërmjet palëve Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation.

Marrëveshjet nuk do të çonin në parandalimin, kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në tregun përkatës, duke mos qenë marrëveshje kufizuese sipas nenit 4/1 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Marrëveshjet nuk përmbanin kufizime të veprimtarisë së ndërmarrjeve pjesëmarrëse dhe nuk kufizonin konkurrencën në lidhje me produktet objekt i marrëveshjeve. Këto marrëveshje do të ndihmojnë në rritjen e prodhimit, gjenerimin e efekteve pozitive për konsumatorët dhe

konkurrencën në tregun shqiptar në përgjithësi, duke përfshirë një përzgjedhje më të gjerë dhe me më shumë alternativa në produktin e cigareve pa djegie, zgjerimin e rrjetit të shpërndarjes dhe do të rrisin mundësinë e zgjedhjeve konsumatore për produkte të reja.

Për këto arsye, KK me vendimin nr. 983, datë 11.05.2023 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjeve të lidhura ndërmjet shoqërive Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation”, vendosi të përjashtojë nga ndalimi “Marrëveshjen Kuadër për Tregtimin dhe Licencën e Teknologjisë”, “Marrëveshjen për Licencën e Markës Tregtare” dhe “Marrëveshjen e Shërbimit për Furnizimin dhe Logjistikën”, të lidhura ndërmjet palëve Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation, për një periudhë 2 (dy) vjeçare, nga marrja e vendimit.

## 2.5 Kontrolli i përqendrimeve

### KONTROLLI I PËRQENDRIMEVE

#### TRANSAKSIONE NË TREGUN E BRENDSHËM

- *Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët, nga shoqëritë Eagle Hills Real Estate Development SHPK dhe Albanian Seaports Development Company SHA.*
- *Përfëtimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA nga shoqëritë BP Holdings International B.V. dhe United World Technologies B.V.*
- *Përfëtimi i kontrollit të shoqërisë DELGI SHPK nga shoqëria SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA SHPK*
- *Përfëtimi i kontrollit të shoqërive METRO FARMACI SHPK; AVICENA SHPK dhe DELTA PHARMA - AL SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK*
- *Bashkimi me përthithje i shoqërisë GEGA OIL SHA nga shoqëria GENKLAUDIS SHA.*
- *Përfëtimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë DONI FRUITS SHPK nga shoqëria Gjonaj Group Holdings SHPK dhe Z. Ejup Ahmeti”*
- *Përfëtimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë FIER Thermoelectric SHA nga shoqëritë DEPA Commercial S.A., GEK TERNA S.A. dhe GENER 2 SHPK”.*
- *Përfëtimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK nga shoqëritë AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TID SHPK.*

#### TRANSAKSIONE NË TREGUN E JASHTËM

- *43 transaksione në tregun e jashtëm*

Në nenin 10, pika 1 të ligjit nr. 9121/2003, parashikohet se përqendrime të ndërmarrjeve kemi në rastet kur shkaktohet një ndryshim i qëndrueshëm i kontrollit si rrjedhojë e:

- a) Bashkimit të dy ose më shumë ndërmarrjeve ose pjesë ndërmarrjesh të pavarura nga njëra – tjetra;




- b) Përfitimit të kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga një ose më shumë persona fizikë, të cilët njëkohësisht kanë kontrollin e të paktën një ndërmarrje tjetër ose nga një ose më shumë ndërmarrje, mbi një ose më shumë ndërmarrje ose pjesë të këtyre të fundit, përmes blerjes së aksioneve, kuotave ose aseteve, kontratës ose çdo mjeti të ligjshëm;
- c) Kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi një ose më shumë ndërmarrje ose të një pjese të këtyre të fundit.

Një perqendrim, bëhet objekt shqyrtimi nga ana e AK, nëse përmbushet edhe kufiri i xhiros së parashikuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ku parashikohet se “Perqendrimet e ndërmarrjeve njoftohen në Autoritet, për të marrë autorizim, nëse, në vitin e fundit financiar, para perqendrimit:

- a) xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku, në tregun ndërkombëtar, është më shumë se 7 miliardë lekë dhe xhiroja e të paktën një ndërmarrje pjesëmarrëse në tregun e brendshëm, është më shumë se 200 milionë lekë.
- b) xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku në tregun e brendshëm është më shumë se 400 milionë lekë dhe xhiroja e të paktën një ndërmarrje pjesëmarrëse, në tregun e brendshëm, është më shumë se 200 milionë lekë”.

Gjatë vitit 2023 pranë AK janë njoftuar 76 transaksione, nga të cilat:


- 54 transaksione ka kaluar në procedurat e kontrollit të perqendrimeve dhe janë autorizuar nga KK në kuptim të nenit 56, pika 1 e ligjit nr. 9121/2003.
- 22 transaksione nuk kanë plotësuar kriteret e ligjit dhe janë kualifikuar si vlerësime ligjore.




Referuar tregjeve të prekura nga transaksioni rezulton se:

- 43 vendime autorizimi janë transaksione që kanë ndodhur në tregun e jashtëm ;

- 11 vendime autorizimi janë transaksione, që kanë ndodhur në tregun shqiptar;



Tregjet më të prekura nga transaksionet kanë qenë tregu i prodhimit të energjisë elektrike, tregu i pajisjeve elektronike dhe software, tregu i tregtimit me shumicë dhe pakicë (produkte ushqimore, bujqësore, industriale, plehra kimike, etj), etj. Ndërkohë në tregun e brendshëm, transaksionet e autorizuara kanë prekur tregun farmaceutik dhe tregun e ndërtimit.



Në nenin 73, pika 1 germa (b) dhe (dh) të ligjit nr. 9121/2003, është parashikuar që KK vendos gjoba, në masën jo më shumë se 1 përqind të xhiros totale të vitit paraardhës financiar, mbi ndërmarrjet ose grupimet e ndërmarrjeve nëse:

- japin të dhëna të pasakta, të paplota ose të rreme në njoftimet, sipas neneve 12 e 49 të këtij ligji, ose të dhëna dhe dokumente plotësuese të pasakta e të paplota, sipas nenit 55 të këtij ligji;

- nuk njofton një përqendrim, sipas neneve 10 dhe 12 të këtij ligji ( afati 30 ditor nga lidhja e kontratës/marrëveshjes).

Gjatë vitit 2023, KK ka marrë 3 vendime dhe ka vendosur 5 gjoba për shkelje të nenit 73, në vlerën totale 22.514.566 lekë dhe konkretisht:

- Vendimi nr. 993 datë 08.06.2023 “Për vendosje gjobe ndaj shoqërisë GEGA OIL GROUP SHA, për mos-njoftim brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje të shoqërisë GEGA OIL SHA nga shoqëria GENKLAUDIS SHA.”;
- Vendimi nr. 1005 datë 27.07.2023 “Për vendosje gjobe ndaj shoqërisë AIR BP Albania SHA për deklarim të të dhënave të paplota dhe të pasakta.”;
- Vendimi nr. 996, datë 05.07.2023, “Për vendosje gjobe ndaj shoqërive AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar për përfundimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK”, i ndryshuar.

### **2.5.1 Transaksione në tregun e brendshëm**

AK ka autorizuar 11 transaksione të realizuara në tregun shqiptar, të cilat të detajuara sipas tregjeve paraqiten si më poshtë:

#### ***Tregu i infrastrukturës së ndërtimit dhe shërbimeve të transportit ajror, detar, hekurudhor.***

Në këtë treg, gjatë vitit 2023, janë vlerësuar 3 transaksione dhe konkretisht:

- *Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, nga shoqëritë Eagle Hills Real Estate Development SHPK dhe Albanian Seaports Development Company SHA.*

KK, me vendimin nr. 971, datë 07.04.2023 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, nga shoqëritë Eagle Hills Real Estate Development SHPK dhe Albanian Seaports Development Company SHA”, autorizoi krijimin e një ndërmarrje të përbashkët, Durrës Marina SHA.

Ndërmarrja e përbashkët do të ushtrojë aktivitetin në zbatim të ligjit nr.79, datë 24.11.2022 “Për miratimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Eagle Hills Real Estate Development, Albanian Seaports Development Company SHA, dhe NSHMI Development L.L.C., në lidhje me projektin e investimit strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit”.

Ndërmarrja e përbashkët do të jetë një shoqëri aksionare me ofertë private, e cila do të ushtrojë biznesin, që nënkupton zhvillimin e një resorti të pasurive të paluajtshme për përdorime të ndryshme si edhe të marinës në Territorin e Projektit, në përputhje me Master Planin dhe Master Planin e Marinës, si dhe operimin dhe menaxhimin e veprimtarive të ndryshme të biznesit në pajtim me Planin e Biznesit dhe Planin e Biznesit për Marinën.

Në lidhje me këtë projekt, Komisioni i Konkurrencës është shprehur me vendimin nr. 917, datë 24.10.2022 “Mbi disa rekomandime në lidhje me draft Marrëveshjen Kuadër për projektin e investimit strategjik “Marina dhe Jahtet e Durrësit” dhe marrëveshjeve të tjera të dakortësuara ndërmjet Komitetit të Negociimit të Marrëveshjeve dhe Subjektit Investues, Eagle Hills Real Estate Development SHPK”.

AK vlerësoi se Durrës Marina SHA nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve. Transaksioni i njoftuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun e ndërtimit; shitjes dhe menaxhimit të pasurive të paluajtshme si dhe në tregun e ndërtimit dhe shërbimit të marinës së jahteve në qytetin e Durrësit.

Për këto arsye, KK vendosi:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, nga shoqëritë Eagle Hills Real Estate Development SHPK dhe Albanian Seaports Development Company SHA.
2. Detyrimin e shoqërisë Durrës Marina SHA, të respektojë zbatimin e nenit 9 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, në tregun e shërbimit të marinës së jahteve.
  - *Përftimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA nga shoqëritë BP Holdings International B.V. dhe United World Technologies B.V.*

KK, me vendimin nr. 994, datë 05.07.2023, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA nga shoqëritë BP Holdings International B.V. dhe United World Technologies B.V.”, autorizoi transaksionin e njoftuar.

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i ofrimit të shërbimit të furnizimit me karburant për avionë.

Që prej vitit 2019, AIR BP ALBANIA SHA nuk është operator ekskluziv i furnizimit me karburant të avionëve në Aeroportin Ndërkombëtar Nënë Tereza. Shoqëria AIR BP ALBANIA SHA operon me kontratë ekskluzive në Aeroportin e Kukësit.

Në përfundim të analizës u konstatua se përqendrimi nuk do të krijonte mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sillte ndryshim në strukturën e tregut të shërbimit të furnizimit me karburant JET A-1 për avionët në tregun shqiptar. Për sa më sipër, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nga përftimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA nga shoqëritë BP Holdings International B.V. dhe United World Technologies B.V.

KK me vendimin nr. 1005 datë 27.07.2023 “Për vendosje gjore ndaj shoqërisë AIR BP Albania SHA për deklarim të dhënave të paplota dhe të pasakta”, vendosi gjobë për mosrespektim të nenit 73, pika 1 germa (b) të ligjit nr. 9121/2003.

- *Përftimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK nga shoqëritë AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK.*

KK, me vendimin nr. 995, datë 05.07.2023, “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK nga shoqëritë AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK”, autorizoi transaksionin e realizuar.

Ndërmjet shoqërisë AGNA SHA, TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, INFO-Telecom SHPK dhe Z. Marin Gjonaj ishte nënshkruar “Kontratë shitblerje” më datë 15.04.2021.

Transaksioni kishte sjellë për pasojë ndryshimin e kontrollit të shoqërisë AMB Construction SHPK, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, pika 1, germa (b) e ligjit dhe si i tillë ky transaksion duhet të ishte objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i ndërtimeve.

Transaksioni përbënte një perqendrim konglomerat ku palët pjesëmarrëse në transaksion operonin në tregje të ndryshme. Perqendrimi nuk do të krijonte mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sillte kufizim të konkurrencës në tregun shqiptar.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë perqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK nga shoqëritë AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK.

KK, me vendimin nr. 996, datë 05.07.2023, “Për vendosje gjome ndaj shoqërive AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK, për mos njoftimin brenda afatit të perqendrimit të realizuar për përfutimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK”, i ndryshuar, vendosi gjombë për mosrespektim të nenit 73, pika 1 germa (dh) të ligjit nr. 9121/2003.

- *Përftimi i kontrollit të shoqërisë DELGI SHPK nga shoqëria SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA SHPK.*

KK, me vendimin nr. 1010, datë 29.08.2023 “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë DELGI SHPK nga shoqëria SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA SHPK”, autorizoi perqendrimin e njoftuar.

Treg përkatës, në këtë transaksion, u konsiderua tregu i nxjerrjes dhe shitjes me shumicë të mineralit të gips alabastër. Përftimi i kontrollit të shoqërisë DELGI SHPK nga shoqëria SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA SHPK do të krijojë mbivendosje vertikale në aktivitetin e palëve pjesëmarrëse në transaksion, e cila pritet të sjellë rritjen e kapacitetit nxjerrës dhe përpunues të shoqërisë target, DELGI SHPK, si dhe ulje të kostove të lëndës së parë dhe përmirësim të efikasitetit ekonomike të shoqërisë blerëse Saint-Gobain SHPK. Ky perqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i

krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nga përftimi i kontrollit të shoqërisë DELGI SHPK nga shoqëria SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA SHPK.

### *Tregu i barnave*

Në këtë treg, gjatë vitit 2023, janë vlerësuar 3 transaksione dhe konkretisht:

- *Përftimi i kontrollit të shoqërisë METRO FARMACI SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 977, datë 26.04.2023, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimitit të kontrollit të shoqërisë METRO FARMACI SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK”

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i barnave dhe suplementeve ushqimore.

Shoqëria target, METRO FARMACI SHPK, nuk ka kryer aktivitete ekonomike gjatë vitit 2021, por nëpërmjet kontrollit të shoqërisë Ditë e Natë SHPK, ushtron influencë në tregun e shitjes me pakicë të barnave dhe suplementeve ushqimore, nëpërmjet një rrjeti farmacish.

Duke qenë se shoqëria DELTA HOLDING SHPK nuk operon në tregun përkatës të produktit, përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimitit të kontrollit të shoqërisë METRO FARMACI SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK.

- *Përftimi i kontrollit të shoqërisë AVICENA SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 978, datë 26.04.2023 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimitit të kontrollit të shoqërisë AVICENA SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK”.

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i barnave dhe suplementeve ushqimore.

Shoqëria AVICENA SHPK operon në tregtimin me shumicë të barnave (importues dhe shpërndarës). Nga përpunimi i të dhënave të importit të barnave, rezultoi se shoqëria AVICENA SHPK ka realizuar importe të barnave gjatë dy viteve të fundit, por me një pjesë shumë të vogël të tregut për vitin 2021 dhe 2022. Struktura e tregut të importit të barnave i jep tregut karakteristikat e një tregu konkurrues, ku indeksi i përqendrimit HHI është më i vogël se 800 për vitin 2021 dhe 2022.

Transaksioni i përfimitit të kontrollit të shoqërisë AVICENA SHPK nga shoqëria DELTA HOLDINGS SHPK nuk do të ketë efekte të ndjeshme në ndryshimin e strukturës së tregut pasi

shoqëria AVICENA SHPK zotëron një pjesë shumë të vogël të tregut dhe ndryshimi i Indeksit të Perqendrimit të tregut do të jetë i papërfillshëm. Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë perqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë AVICENA SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK.

- *Përfimi i kontrollit të shoqërisë DELTA PHARMA - AL SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK.*

KK autorizoi perqendrimin me vendimin nr. 979, datë 26.04.2023 “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë DELTA PHARMA - AL SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK”.

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i barnave dhe suplementeve ushqimore.

Transaksioni i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, KK vendosi të autorizojë perqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë DELTA PHARMA - AL SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK.

#### ***Tregu i Pajisjeve elektronike dhe software***

Në këtë treg, gjatë vitit 2023, është vlerësuar 1 transaksion dhe konkretisht:

- *Përfimi i kontrollit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të shoqërisë Infosoft Systems SHPK nga z. Armand Sharra.*

KK autorizoi perqendrimin me vendimin nr. 998, datë 05.07.2023, “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të shoqërisë Infosoft Systems SHPK nga z. Armand Sharra”.

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i shërbimeve të teknologjisë së informacionit. Shoqëria Tag Engineering SHPK nuk ushtronte të njëjtin aktivitet ekonomik me shoqërinë Target.

Përfimi i kontrollit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të shoqërisë Infosoft Systems SHPK nga z. Armand Sharra nuk do të sillte mbivendosje horizontale të aktivitetit ekonomik të shoqërisë Infosoft Systems SHPK dhe Tag Engineering SHPK, pasi shoqëritë operonin në tregje të ndryshme.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë perqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të shoqërisë Infosoft Systems SHPK nga z. Armand Sharra.

#### ***Tregu i Hidrokarbureve, industria minerare dhe përpunuese.***

Në këtë treg, gjatë vitit 2023, është vlerësuar 1 transaksion i cili ka ndodhur në tregun shqiptar dhe konkretisht:

- *Bashkimi me përthithje i shoqërisë GEGA OIL SHA nga shoqëria GENKLAUDIS SHA*

KK autorizoi perqendrimin me vendimin nr. 992, datë 08.06.2023, “Mbi autorizimin e perqendrimit

të realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje të shoqërisë GEGA OIL SHA nga shoqëria GENKLAUDIS SHA”.

AK, mbështetur në informacionin e administruar gjatë procedurave hetimore në tregun e karburanteve, si dhe pas verifikimit të ekstraktit historik të shoqërive GEGA OIL GROUP SHA dhe GEGA OIL SHA, konstatoi se, në datë 02.03.2021 ishte nënshkruar marrëveshja e bashkimit me përthithje mes shoqërive GENKLAUDIS SHA (shoqëria përthithëse) dhe GEGA OIL SHA (shoqëria e përthithur).

Referuar marrëveshjes si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni i bashkimit me përthithje i shoqërisë GEGA OIL SHA nga shoqëria GENKLAUDIS SHA, përbënte një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë u bë objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Treg përkatës i prekur nga transaksioni u konsiderua tregu i shitjes me shumicë të karburanteve, i ndarë në dy nëntregje: - nëntregu i produktit benzinë; - nëntregu i produktit naftë.

Transaksioni i bashkimit me përthithje të shoqërisë Genklaudis SHA dhe Gega Oil SHA përbën një përqendrim horizontal, pasi palët pjesëmarrëse në transaksion ishin konkurrentë të afërt që vepronin në të njëjtin treg përkatës.

AK realizoi procedurën e kontrollit ex-post të përqendrimit dhe tregu i shitjes me shumicë të karburanteve ka reflektuar de fakto, efektet e transaksionit të bashkimit mes konkurrenteve në të njëjtin treg.

Përqendrimi ka krijuar mbivendosje midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar në tregun e naftës dhe benzinës, por pa efekte të ndjeshme në strukturën e tregut për shkak të pjesës së vogël të tregut të ndërmarrjes së përthithur.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje të shoqërisë GEGA OIL SHA nga shoqëria GENKLAUDIS SHA.

KK me vendimin nr. 993 datë 08.06.2023 “Për vendosje gjore ndaj shoqërisë GEGA OIL GROUP SHA, për mos-njoftim brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje të shoqërisë GEGA OIL SHA nga shoqëria GENKLAUDIS SHA.”, vendosi gjobë për mosrespektim të nenit 73, pika 1 germa (dh) të ligjit nr. 9121/2003.

### ***Tregu i import-eksportit dhe tregtimit të fruta perimeve***

- *Përfitim i kontrollit të përbashkët të shoqërisë DONI FRUITS SHPK nga shoqëria Gjonaj Group Holdings SHPK dhe Z. Ejup Ahmeti”.*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1036, datë 12.12.2023 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë DONI FRUITS SHPK nga shoqëria Gjonaj Group Holdings SHPK dhe Z. Ejup Ahmeti”.



Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i import-eksportit dhe tregtimit të fruta perimeve.

Transaksioni synon rritjen e aktivitetit të palës blerëse nëpërmjet realizimit të investimeve të reja.

Perqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë perqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë DONI FRUITS SHPK nga shoqëria Gjonaj Group Holdings SHPK dhe Z. Ejup Ahmeti.

### ***Tregu i prodhimit dhe furnizimit me shumicë të energjisë elektrike***

- *Përfutimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë FIER Thermoelectric SHA nga shoqëritë DEPA Commercial S.A., GEK TERNA S.A. dhe GENER 2 SHPK”.*

KK autorizoi perqendrimin me vendimin nr. 1044, datë 29.12.2023 “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë FIER Thermoelectric SHA nga shoqëritë DEPA Commercial S.A., GEK TERNA S.A. dhe GENER 2 SHPK”.

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i prodhimit dhe furnizimit me shumicë të energjisë elektrike.

Perqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim aktualisht në tregun shqiptar.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë perqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë FIER Thermoelectric SHA nga shoqëritë DEPA Commercial S.A., GEK TERNA S.A. dhe GENER 2 SHPK.

### **2.5.2 Transaksione në tregun e jashtëm**

Në zbatim të nenit 12 të ligjit nr. 9121/2003, objekt i vlerësimit të perqendrimit janë transaksione, të cilat ndodhin në tregun e jashtëm, por që realizojnë të ardhura në tregun shqiptar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

KK, për vitin 2023, ka autorizuar 43 raste të renditura si më poshtë:

1. Vendimi nr. 928, datë 05.12.2022, “Mbi autorizimin e perqendrimit të përkohshëm, të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive GR Vale S.A.C. dhe GR Bayovar S.A.C., nga shoqëritë Statkraft Peru S.A. dhe Statkraft Peru Holding S.A.C.”.

KK vendosi të autorizojë përkohësisht perqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar

të aksioneve të shoqërive GR Vale S.A.C. dhe GR Bayovar S.A.C. nga shoqëritë Statkraft Peru S.A. dhe Statkraft Peru Holding S.A.C., dhe autorizimi i perqendrimit të përkohshëm do të ishte i vlefshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët në transaksion.

Vendimi nr. 954, datë 19.01.2023 “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar mbi përfitim e kontrollit të shoqërive GR Vale S.A.C. dhe GR Bayovar S.A.C. nga shoqëritë Statkraft Peru S.A. dhe Statkraft Peru Holding S.A.C.”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nga burime jo-konvecionale dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

2. Vendimi nr. 953, datë 19.01.2023, “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë paragon semvox nga shoqëria CARIAD SE”. Transaksioni ndodh në tregun e zhvillimit dhe integritit të softuerit të dialogut të ndërveprimit të bazuar në inteligjencën artificiale (AI) me fokus në zgjidhjet për industrinë e automjeteve dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

3. Vendimi nr. 955, datë 31.01.2023, “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar mbi përfitim e kontrollit të shoqërisë Vum, a.s., nga shoqëria Elkem Carbon AS”. Transaksioni ndodh në tregun e produkteve të karbonit dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

4. Vendimi nr. 956, datë 31.01.2023, “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota (JV) nga shoqëritë CARIAD Estonia AS dhe Horizon Together Holding Ltd.”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit të çipave dhe softuerëve inteligjent të drejtimit të automjeteve dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

5. Vendimi nr. 957, datë 31.01.2023, “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar mbi përfitim e kontrollit të përbashkët të shoqërive Bore Array Limited dhe North Irish Sea Array Windfarm Limited nga Grupi Copenhagen Infrastructure Partners dhe Statkraft Ireland Limited”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit të energjisë së rinovueshme nga era në det të hapur (offshore) dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

6. Vendimi nr. 958, datë 31.01.2023, “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Vodafone Magyarország Távközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság nga shoqëria "ANTENNA HUNGÁRIA" Magyar Műsorszóró és Rádióhírközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság”. Transaksioni ndodh në tregun e komunikimeve elektronike dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

7. Vendimi nr. 959, datë 13.02.2023 “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Terreal Holding S.A.S nga shoqëria Wienerberger Participations S.A.S.”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit të materialeve të ndërtimit dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

8. Vendimi nr. 960 datë 13.02.2023 “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Joint - Stock Commercial Mortgage Bank “IPOTEKA – BANK” nga shoqëria OTP Bank Nyrt”. Transaksioni ndodh në tregun e ofrimit të shërbimeve bankare dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

9. Vendimi nr. 962, datë 28.02.2023, “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Assist Digital S.p.A. nga shoqëria Freedom 1 s.r.l. dhe disa persona fizikë”. Transaksioni ndodh në tregun e shërbimeve të menaxhimit të klientit dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.
10. Vendimi nr. 965, datë 17.03.2023, “Mbi autorizimin e perqendrimit të përkohshëm të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të kuotave të shoqërisë Khidrat Renewable Energy Private Limited nga shoqëria Sourya Manthan Renewable Energy Private Limited”. KK vendosi të autorizojë përkohësisht perqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të kuotave të shoqërisë Khidrat Renewable Energy Private Limited nga shoqëria Sourya Manthan Renewable Energy Private Limited dhe autorizimi i perqendrimit të përkohshëm do të ishte i vlefshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët në transaksion.

Vendimi nr. 973, datë 07.04.2023, “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së aksioneve të shoqërisë Khidrat Renewable Energy Private Limited nga shoqëria Sourya Manthan Renewable Energy Private Limited”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nga burime jo-konvecionale dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

11. Vendimi nr. 967, datë 24.03.2023 “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë FG South East Europe S.A nga shoqëria FUJITSU GENERAL (Euro) GmbH”. Transaksioni ndodh në tregun e kondicionerëve, pajisjeve elektroshtëpiake dhe pajisjeve telefonike dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.
12. Vendimi nr. 968, datë 24.03.2023 “Mbi autorizimin e perqendrimit të përkohshëm të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd.”. KK vendosi të autorizojë përkohësisht perqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd. dhe autorizimi i perqendrimit të përkohshëm do të ishte i vlefshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët në transaksion.

Vendimi nr. 986, datë 24.05.2023 “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar mbi përfutimin e kontrollit nëpërmjet blerjes së aksioneve të shoqërive Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd.”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nga burime jo-konvecionale dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

13. Vendimi nr. 972, datë 07.04.2023, “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Njesisë së Biznesit “Mobility Servis Platform” nga shoqëria CARIAD SE”. Transaksioni ndodh në tregun e ofrimit të shërbimeve IT për programim/zhvillim softueri të bërë me porosi (softuer individual) dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.
14. Vendimi nr. 974, datë 14.04.2023, “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë NIRA Dynamics AB nga shoqëria CARIAD SE”. Transaksioni ndodh në tregun e kërkimit dhe zhvillimit të zgjidhjeve softuerike të shpëtimit,

veçanërisht në sistemet e monitorimit dhe paralajmërimit për industrinë e automjeteve dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

15. Vendimi nr. 982, datë 11.05.2023 “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të aseteve të shoqërisë Breeze Two Energy GmbH & Co.KG, nga shoqëria Statkraft Germany GmbH”. KK vendosi të autorizojë përkohësisht perqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të aseteve të shoqërisë Breeze Two Energy GmbH & Co.KG, nga shoqëria Statkraft Germany GmbH.

Vendimi nr. 1032, datë 14.11.2023 “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërive Statkraft Windenergie GmbH & Co.KG dhe Eoliennes Suroit SNC nga shoqëritë Statkraft Germany GmbH, Statkraft Holding Wind & Solar Deutschland GmbH dhe Statkraft Renouvelables Sasu”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nga burime jo-konvecionale dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

16. Vendimi nr. 981, datë 11.05.2023, “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Saudi Aramco Development Co Ltd. dhe Excel Investments Netherlands B.V.”. Transaksioni ndodh në tregun për kontraktimin e shërbimeve logjistike dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

17. Vendimi nr. 985, datë 24.05.2023, “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Shanghai Muchuan Industrial Design Co., Ltd nga shoqëria CARIAD Estonia AS”. Transaksioni ndodh në tregun për zgjidhjet softuerike dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

18. Vendimi nr. 988, datë 24.05.2023 “Mbi perqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Gruppo Zaffiro S.r.l. nga shoqëritë Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A. dhe Sarafin S.p.A.”. Transaksioni ndodh në tregun për ofrimin e shërbimeve të kujdesit dhe shëndetit social, nëpërmjet menaxhimit të shtëpive të kujdesit për të moshuar dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

19. Vendimi nr. 991, datë 08.06.2023 “Mbi autorizimin e perqendrimit të përkohshëm të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive Eólica CQN Uno SpA dhe Eólica CQN Dos SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A”. KK vendosi të autorizojë përkohësisht perqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive Eólica CQN Uno SpA dhe Eólica CQN Dos SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A.

Vendimi nr. 1006, datë 28.07.2023 “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërive Eólica CQN Uno SpA dhe Eólica CQN Dos SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nga burime jo-konvecionale dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

20. Vendimi nr. 997, datë 05.07.2023, “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të kuotave të shoqërisë Parque Eólico Litueche SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A.”. KK vendosi të autorizojë përkohësisht perqendrimin e realizuar.

Vendimi nr. 1030, datë 03.11.2023, “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Parque Eólico Litueche SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A.”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nga burime jo-konveconale dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

21. Vendimi nr. 1007, datë 29.08.2023, “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë CIRCOR International, Inc. nga KKR & Co, Inc. nëpërmjet shoqërisë Cube BidCo, Inc.”. Transaksioni ndodh në tregun e projektimit, prodhimit dhe shitjes së produkteve dhe nën-sistemeve teknologjike të dalluara për tregjet industriale, ajrore dhe mbrojtjes dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

22. Vendimi nr. 1001, datë 17.07.2023, “Mbi autorizimin e perqendrimit të përkohshëm të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të kuotave të shoqërisë GGE Ireland Limited dhe shoqërisë EMP Energy Limited nga shoqëria Statkraft Ireland Limited”. KK vendosi të autorizojë përkohësisht perqendrimin e realizuar.

Vendimi nr. 1009, datë 29.08.2023, “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërive GGE Ireland Limited dhe EMP Energy Limited nga shoqëria Statkraft Ireland Limited”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nga burime jo-konveconale, ajrore dhe mbrojtjes dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

23. Vendimi nr. 1008, datë 29.08.2023 “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Efacec Power Solutions, SGPS S.A. nga shoqëria Mutares SE & Co. KGaA”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit të pajisjeve për sektorin e energjisë, duke përfshirë transformatorët, pajisjet e tensionit të lartë dhe të mesëm, pajisjet e shpërndarjes parësore dhe dytësore, zhvillimin e teknologjisë së automatizimit dhe menaxhimit të rrjetit dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

24. Vendimi nr. 1011, datë 13.09.2023 “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, nga shoqëritë Messer Se & Co. Kгаа dhe Toyota Tsusho Europe”. Transaksioni ndodh në tregun e dhënies me qira, menaxhimit dhe mirëmbajtjes së flotës së automjeteve të lëvizshme me hidrogjen dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

25. Vendimi nr. 1012, datë 13.09.2023 “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Vrumona B.V. nga shoqëria Royal Unibrew A/S nëpërmjet shoqërisë Company of June 2023 B.V.”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit dhe tregtimit të pijeve freskuese dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

26. Vendimi nr. 1015, datë 21.09.2023 “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë D Way Doo nga shoqëria Nelt Co. Doo Beograd dhe përfutimit të kontrollit të shoqërisë D Way nga shoqëria Neregelia.” Transaksioni ndodh në tregun e ofrimit të shërbimeve të logjistikës të biznesit dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

27. Vendimi nr. 1016, datë 21.09.2023 “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë të shoqërive MHB Wind Farms (Holdings) Limited dhe

Taurbeg Limited nga shoqëria Statkraft Ireland Limited”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nga burime jo-konvecionale dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

28. Vendimi nr. 1018, datë 29.09.2023 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë BOSIS DOO VALJEVO nga shoqëria DS Smith Packaging South East GmbH”. Transaksioni ndodh në tregun e kutive të valëzuara të lito-petëzuar dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.
29. Vendimi nr. 1019, datë 29.09.2023 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët / joint – venture, me funksione të plota, nga shoqëritë Saudi Arabian Oil Company, Baoshan Iron & Steel Co., Ltd. dhe Public Investment Fund ”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit dhe shitjes së pllakave të rënda të çelikut dhe prodhimit dhe shitjes së hekurit të reduktuar dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.
30. Vendimi nr. 1020, datë 29.09.2023 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të aseteve të Biznesit në Tokë të shoqërisë Winns AS nga shoqëria Statkraft Varne AS”. Transaksioni ndodh në tregun e ofrimit të sistemeve të energjisë për ngrohjen dhe ftohjen e ndërtesave tregtare dhe rezidenciale dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.
31. Vendimi nr.1021, datë 13.10.2023 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së kuotave të shoqërisë Svevind Nordic AB nga shoqëria Statkraft Sverige AB”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nga burime jo-konvecionale, dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.
32. Vendimi nr. 1022, datë 13.10.2023 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërive Jerusalem Holding S.A., Central Eolica Baqueirao I S.A. dhe Central Eolica Baqueirao II S.A. nga shoqëria Statkraft Energias Renovaveis S.A”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nga burime jo-konvecionale dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.
33. Vendimi nr. 1023, datë 13.10.2023 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Njordr Offshore Wind AB nga shoqëria Statkraft Offshore Wind AS”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nga burime jo-konvecionale dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.
34. Vendimi nr. 1024, datë 13.10.2023 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Tecnofer S.p.A. nga shoqëritë Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A. dhe Ersel Asset Management S.G.R S.p.A”. Transaksioni ndodh në tregun e kryerjes së shërbimeve të mirëmbajtjes së hekurudhës dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.
35. Vendimi nr. 1027, datë 26.10.2023 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Biznesit Target të shoqërisë Artemis OOD nga shoqëria Smurfit Kappa Bulgaria EOOD”. Transaksioni ndodh në tregun e paketimeve fleksibël dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

36. Vendimi nr. 1028, datë 26.10.2023 “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ABO Wind WP Flechtdorf GmbH & Co. KG nga SK Wind GmbH & Co. KG”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nga burime jo-konvecionale dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.
37. Vendimi nr. 1029, datë 03.11.2023 “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 41% të kuotave të shoqërisë Italia Trasporto Aereo S.p.A. nga shoqëria Deutsche Lufthansa Aktiengesellschaft”. Transaksioni ndodh në tregun e shërbimeve të transportit ajror civil dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.
38. Vendimi nr. 1033, datë 14.11.2023 “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë Route Mobile Limited nga shoqëria Proximus Opal”. Transaksioni ndodh në tregun e Platformës së Komunikimit si Shërbim (CPaaS) dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.
39. Vendimi nr. 1034, datë 05.12.2023 “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm nga shoqëria CSIC Longjiang GH Gas Turbine Co., Ltd mbi asetet e Biznesit të turbinave me gaz të MAN Energy Solutions SE”. Transaksioni ndodh në tregun e turbinave me gaz dhe tregu i shërbimeve pas shitjes për turbinat me gaz dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.
40. Vendimi nr. 1035, datë 05.12.2023 “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Volvo Business Services International AB dhe Renault s.a.s.”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit dhe furnizimit të automjeteve tregtare të lehta dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.
41. Vendimi nr. 1037, datë 12.12.2023 “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Levi Rally Center Oy nga shoqëria Dr. Ing.h.c.F. Porsche Aktiengesellschaft, nëpërmjet shoqërisë Porsche Investments Management S.A”. Transaksioni ndodh në tregun e ofrimit të ambienteve dhe programeve për testimin dimëror të automjeteve dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.
42. Vendimi nr. 1038, datë 22.12.2023 “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së kapitalit aksionar të Simon & Schuster (UK) Ltd dhe Simon & Schuster, Inc. nga Century DE Buyer LLC dhe Century UK Buyer Ltd.” Transaksioni ndodh në tregun e botimit dhe shitjes së librave tregtarë (përfshirë libra të shtypur, libra në format elektronik dhe audio-libra) dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.
43. Vendimi nr. 1039, datë 22.12.2023 “Mbi autorizimin e perqendrimit të realizuar nëpërmjet të shoqërisë WestRock Company nga shoqëria Smurfit Kappa Group plc.” Transaksioni ndodh në tregun e kartonave të palosshëm dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

## **PJESA E TRETË**

### **AUTORITETI I KONKURENCËS PËRBALLË PROCESIVE GJYQËSORE**

AK i kushton rëndësi të veçantë ndjekjes së procedurave gjyqësore, duke qenë aktiv në të gjitha këto procese në shkallët e gjykimit nëpërmjet paraqitjes së argumenteve dhe provave në mbështetje të vendimeve të marra nga KK.

Ndjekja e çështjeve gjyqësore lidhet me ndikimin që kanë vendimet e KK në tregun përkatës dhe në publikun e gjerë si dhe me faktin që pothuajse të gjitha vendimet e komisionit për marrje masash ndaj ndërmarrjeve, i janë nënshtruar procesit të ankimimit në gjykatë.

#### **3.1 Çështje të gjykuara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë**

Pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, gjatë vitit 2023 AK ka patur në shqyrtim 12 çështje, ku janë rrëzuar 4 (katër) kërkesë padi, pranuar 2 (dy) kërkesë padi dhe janë në proces 6 (gjashtë) kërkesë padi.

1. Çështja gjyqësore me palë paditëse: Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) dhe të paditur AK, me objekt: Shfuqizimi i pikës 2 të VKK nr.852, datë 24.12.2021 të Autoritetit të Konkurrencës “Për dhënie rekomandimi Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe dhënie detyrimi Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar për rritjen e konkurrencës në ofrimin e shërbimit të auditimit ligjor” .

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është në proces gjykimi të çështjes.

2. Çështja gjyqësore me palë paditëse ndërmarrjen BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD, dhe të paditur AK, me objekt: Shfuqizimin e vendimit të Autoritetit të Konkurrencës me Nr. 918, datë 26.10.2022 të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi gjobitjen e ndërmarrjes BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD për mos - zbatim të vendimeve të komisionit të konkurrencës nr. 702, datë 30.07.2020 dhe nr. 793, datë 22.04.2021”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë vendosi pranimin e kërkesë padisë së ndërmarrjes.

3. Çështja gjyqësore me palë paditëse shoqëritë “AgroBlend” ShPK, “MBM” ShPK, “ÇAÇA” ShPk dhe të paditur AK, me objekt : Shfuqizimi i VKK nr. 874 datë, 25.03.2022 “Shqyrtimi i Raportit “Mbi hetimin e thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure, ndaj ndërmarrjeve: ARLI INTERNACIONAL SHPK, AGRO BLEND SHPK, MBM SHPK, ECO-GREEN SHPK, LILA SHPK, AGRO-MENS SHPK, ÇAÇA SHPK, IAM SHPK, AGROHELPSA SHPK dhe BESNIKU SHPK”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vendosi pranimin e kërkesë padisë së ndërmarrjeve. Autoriteti i konkurrencës ka ushtruar të drejtën e saj për ankimimin e vendimit në Gjykatën e Apelit.



4. Çështja gjyqësore me palë paditëse ndërmarrjen “ AgroBlend” ShPK dhe të paditur AK, me objekt: Shfuqizimi i VKK nr.935, datë 16.12.2022 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK për moszbatimin e detyrimeve të përcaktuara me VKK nr. 839, datë 29.09.2021” për pjesën e shoqërisë “Agro Blend” SHPK.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vendosi rrëzimin e kërkesë padisë.

5. Çështja gjyqësore me palë paditëse ndërmarrjen “ Atlas Mills” ShPK dhe të paditur AK, me objekt: Shfuqizimi i VKK nr.935, datë 16.12.2022 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK për moszbatimin e detyrimeve të përcaktuara me VKK nr. 839, datë 29.09.2021” për pjesën e shoqërisë “Atlas Mills” SHPK.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vendosi rrëzimin e kërkesë padisë.

6. Çështja gjyqësore me palë paditëse ndërmarrjen “ Bloja” SHA dhe të paditur AK, me objekt: Shfuqizimi i VKK nr.935, datë 16.12.2022 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK për moszbatimin e detyrimeve të përcaktuara me VKK nr. 839, datë 29.09.2021” për pjesën e shoqërisë “Bloja” SHA.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është në proces gjykimi të çështjes.

7. Çështja gjyqësore me palë paditëse ndërmarrjen “ Miell Tirana” SHA dhe të paditur AK, me objekt: Shfuqizimi i VKK nr.935, datë 16.12.2022 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK për moszbatimin e detyrimeve të përcaktuara me VKK nr. 839, datë 29.09.2021” për pjesën e shoqërisë “Miell Tirana” SHA.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është në proces gjykimi të çështjes.

8. Çështja gjyqësore me palë paditëse ndërmarrjen “Gega Oil Group” SHA dhe të paditur AK, me objekt : Shfuqizimi i VKK nr. 993, datë 08.06.2023 “Për vendosje gjobe ndaj shoqërisë Gega Oil Group SHA, për mos njoftim brenda afatit të përqëndrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje shoqërisë ‘Gega Oil SHA’ nga shoqëria ‘Genklaudis SHA’”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është në proces gjykimi të çështjes.

9. Çështja gjyqësore me palë paditëse ndërmarrjen “ Vodafone Albania SHA” dhe të paditur AK, me objekt: Shfuqizimi i VKK nr.952 datë 28.12.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafonë Albania SHA në tregun e shërbimeve celulare Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe dhënien e disa detyrimeve”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë.

10. Çështja gjyqësore me palë paditëse ndërmarrjen “Star Parking Albania” SHPK dhe të paditur AK, me objekt: Pavlefshmëria absolute e VKK nr.921, datë 09.11.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të aeroportit

“NËNË TEREZA” (Tirana International Airport) dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vendosi rrëzimin e kërkesë padisë.

11. Çështja gjyqësore me palë paditëse ndërmarrjen “Neofon” SHPK dhe të paditur AK, me objekt: Ndryshimin e pjesës së VKK nr. 952, datë 28.12.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “Vodafone Albania” SHA në tregun e shërbimeve celulare: Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe dhënien e disa detyrimeve”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është në proces gjykimi të çështjes.

12. Çështja gjyqësore me palë paditëse ndërmarrjen “Air BP Albania” SHA dhe të paditur AK, me objekt shfuqizimi i VKK nr.1005, datë 28.07.2023 “Për vendosje gjobe ndaj shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA për deklarim të të dhënave të paplota dhe të pasakta”

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është në proces gjykimi të çështjes.

### 3.2 Çështje të gjykuara në gjykatën administrative të apelit Tiranë

Në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, përgjatë vitit 2023 nuk ka pasur asnjë çështje.

### 3.3 Çështje të gjykuara në Gjykatën e Lartë

Në Gjykatën e Lartë janë zhvilluar 2 çështje:

1. Çështja gjyqësore me palë paditëse ndërmarrjen “Geci” SHPK dhe të paditur AK, me objekt: Shpalljen e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv VKK nr. 229 datë 07.07.2012 “Për vendosje gjobe ndaj shoqërisë ‘Geci’ SHPK për njoftimin jashtë afatit të përqëndrimit të realizuar nëpërmjet përthithjes së shoqërive Albania Consortium SHA dhe Sky 2009 SHA”.

Gjykata e Lartë ka vendosur mos pranimin e rekursit të AK.

2. Çështja gjyqësore me palë paditëse ndërmarrjet “EuroGjici-Security” SHPK, “Toni Security” SHPK, “EuroGjici Security 1” SHPK dhe të paditur AK me objekt : Shfuqizim (anulimi) pjesërisht i VKK nr. 240, datë 26.07.2012 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Nazëri – 2000” Sh.p.k, dhe “Dea Security” Sh.p.k për kufizim të konkurrencës në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike”.

Gjykata e Lartë ka vendosur rrëzimin e rekursit të AK.

### 3.4 Ekzekutimi i vendimeve të komisionit të konkurrencës

Në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të Komisionit të Konkurrencës për vitin 2023 janë lëshuar 2 (dy) urdhra të rinj ekzekutimi nga Gjykata për VKK nr. 935, datë 23.07.2022 me debitor ndërmarrjen “Agro Blend SHPK” dhe VKK nr.993, datë 08.06.2023 me debitor ndërmarrjen “Gega Oil Group SHA”. Autoriteti i Konkurrencës është në pritje të kryerjes së veprimeve përmbarimore për 7 (shtatë) urdhra ekzekutimi dhe në pritje të lëshimit të urdhrave të ekzekutimit nga ana e Gjykatës për 4 vendime (12 debitorë) të Komisionit të Konkurrencës.

Gjatë vitit 2023 janë ekzekutuar plotësisht ose pjesërisht vendimet si më poshtë:

1. Ekzekutuar plotësisht VKK nr. 749, datë 19.11.2020, me debitor shoqërinë “Fufarma SHA”;
2. Ekzekutuar plotësisht VKK nr. 921, datë 09.11.2022, me debitor shoqërinë “Star Parking SHPK”;
3. Ekzekutuar plotësisht VKK nr. 935, datë 23.07.2022, me debitor ndërmarrjen “Agro Blend SHPK”;
4. Ekzekutuar plotësisht VKK nr. 993, datë 08.06.2023, me debitor ndërmarrjen “Gega Oil Group SHA”;
5. Ekzekutuar pjesa e mbetur e VKK nr. 66/18, datë 18.12.2007, me debitor ndërmarrjen “Kirchberger Albania SHPK”.
6. Ekzekutuar pjesërisht VKK nr. 572, datë 22.11.2018, me debitor ndërmarrjen “EKMA Albania SHPK”.
7. Ekzekutuar pjesërisht VKK nr. 766, datë 22.01.2021, me debitor ndërmarrjen “New Medical Plus SHPK”.

## PJESA E KATËRT

### 4.1 Vlerësimi i akteve dhe projektakteve normative

Në zbatim të neneve 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121/2003, AK, për arsye të interesit të përgjithshëm dhe në bashkëpunim me administratën qendrore dhe vendore, entet dhe institucionet e tjera rregullatore, vlerëson barrierat rregulluese të konkurrencës, të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrativ, të cilat mund të vijnë për shkak të a) kufizimeve sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin; b) vendosjes së të drejtave ekskluzive ose të të drejtave të veçanta, në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara; c) imponimit të praktikave të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes.

Gjatë vitit 2023, AK ka realizuar:

1. Vlerësimin ligjor të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, të lidhur ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Shoqatës “Kombëtare të

Autoshkollave”, Shoqatës së Autoshkollave “Siguria në rrugë” dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”, si dhe kuadrit ligjor dhe nënligjor përkatës që rregullojnë ofrimin e shërbimit të përgatitjes dhe pajisjes me leje drejtimi: VKK nr. 964, datë 01.03.2023, “Për marrjen e masave të përkohshme për ndalimin e zbatimit të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, në lidhje me përcaktimin e tarifës së pagesës dhe kostos minimale fiskale për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimi”; si dhe VKK nr. 970, datë 24.03.2023, “Mbi vlerësimin ligjor të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, të lidhur ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Shoqatës “Kombëtare të Autoshkollave”, Shoqatës së Autoshkollave “Siguria në rrugë” dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”;

2. Vlerësimin ligjor të Rregullores “Për përcaktimin e faktorëve të riskut që përfshihen në përlllogaritjen e primit për produktet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”;
3. Vlerësimin ligjor të Projektvendimit “Për sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit e trajtimit të ujrave të ndotur urban.”.
4. Vlerësimin ligjor të Projektligjit “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport.”.

- *Projektakte normative në tregun e energjisë dhe gazit*

ERE, gjatë vitit 2023, ka dërguar për vlerësim ligjor pranë AK projekt aktet normative në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, si me poshtë vijon:

1. Vendimin nr. 280, datë 01.11.2022 “Mbi miratimin e rregullave të harmonizuara të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit për zyrën e koordinimit të ankandeve në Europën Juglindore (SEE CAO) për kufijtë Shqipëri - Greqi, Shqipëri – Mali i Zi dhe Shqipëri –Kosovë””.
2. Vendimi nr. 286, datë 10.11.2022 “Mbi një ndryshim në Vendimin nr. 242, datë 23.09.2022, të bordit të ERE-s “Mbi kërkesën e shoqërisë FSHU SHA, lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum “Mbi 800 kwh në muaj””.
3. Vendimi nr. 323, datë 14.12.2022 “Mbi shfuqizimin e Vendimit nr. 242, datë 23.09.2022, të bordit të ERE-s “Mbi kërkesën e shoqërisë FSHU SHA, lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum “Mbi 800 kwh në muaj”, i ndryshuar””.
4. Vendimi nr. 324, datë 14.12.2022 “Mbi lënien në fuqi të Vendimit të bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.04.2022 “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit, për periudhën 1 maj – 31 dhjetor 2022””.

5. Vendimi nr. 325, datë 14.12.2022 “Mbi lënien në fuqi të Vendimit të bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.04.2022 “Mbi vlerësimet e ERE për kostot e aktivitetit të furnizuesit të shërbimit universal për periudhën 01.05.2022 – 31.12.2022””.
6. Vendimi nr. 327, datë 14.12.2022 “Mbi miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2023”.
7. Vendimi nr. 347, datë 27.12.2022 “Mbi miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike (rregullat e Alpex përkufizimet, procedura e tregtimit si dhe procedura e **kierimit** dhe shlyerjes”.
8. Vendimi nr. 27, datë 16.02.2023 “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023”.
9. Vendimi nr. 32, datë 20.02.2023 “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqatës shqiptare të furnizuesve të energjisë (AAES) për disa ndryshime në zbatimin e Vendimit të bordit të ERE-s nr. 23, datë 14.02.2022”.
10. Vendimi nr. 180, datë 29.05.2023 “Mbi kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmetimit OST SHA, për miratimin e rregullores “Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar””.
11. Vendimi nr. 186, datë 06.06.2023 “Mbi miratimin e kërkesës së shoqatës shqiptare të furnizuesve të energjisë elektrike (AAES) për disa ndryshime dhe kufizime në zbatimin e Vendimit të bordit të ERE-s nr. 23, datë 14.02.2022”.
12. Vendimi nr. 200, datë 23.06.2023 “Mbi kërkesën e shoqërisë “Bursa shqiptare e energjisë elektrike – ALPEX” SHA, për t’u përcaktuar si operatori i emëruar i tregut të energjisë elektrike (NEMO)”.
13. Vendimi Nr. 228, datë 17.07.2023 “Mbi përcaktimin e shoqërisë “Bursa shqiptare e energjisë elektrike ALPEX” SHA, si operatori i emëruar i tregut të energjisë elektrike (NEMO)”.
14. Vendimi nr. 280, datë 25.09.2023 “Mbi miratimin e rregullores “Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar””.

- *Projektakte normative në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave:*

ERRU, në zbatim të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, ka sjellë për vlerësim ligjor pranë AK projekt aktin normativ mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor, për Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA.

KK, me vendimin nr. 1042, datë 26.12.2023 “Për dhënien e disa rekomandimeve entit rregullator të ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime” Vlorë SHA”, vendosi t’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

- I. Tarifatat e ndryshuara, që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjetllës Kanalizime Vlorë SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
- II. Miratimi i ndryshimit të tarifave, të marra në shqyrtim nga KKRR, të jetë i publikuar në faqen zyrtare elektronike të ERRU.
- III. Të bëhen transparente në faqen zyrtare të Bashkisë Vlorë, UK Vlorë SHA seancat e zhvilluara të dëgjësës publike më palët e interesit për propozimin e ndryshimit të tarifave.

## 4.2 Advokacia e Konkurrencës

Gjatë vitit 2023, AK në kuadër të promovimit të advokacisë dhe kulturës së konkurrencës, ka organizuar tryeza të të rumbullakëta, *workshope* dhe konferenca, me grupet e interesit, botën akademike dhe bizneset.

Në kuadër të promovimit të kulturës së konkurrencës, mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg dhe për të luftuar në mënyrë efektive marrëveshjet në oferta në procedurat e prokurimit publik, AK zhvilloi më datë 6 qershor 2023, Workshop-in me Shoqatën “Bashkimi Tregtar i Shqipërisë” me temë “Marrëveshjet në Oferta në Procedurat e Prokurimit Publik në Kuptim të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Ky aktivitet shërbeu për forcimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive për mirëfunktionimin e tregut, veçanërisht në çështje si prokurimet publike si dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit të Konkurrencës me shoqatën “Bashkimi Tregtar i Shqipërisë” dhe botën e biznesit, me synim identifikimin e mënyrave dhe mjeteve për të adresuar rastet e marrëveshjeve të ndaluara në ofertat publike, rritjen e ndërgjegjësimit për minimizimin e praktikave antikonkurruese të fshehta në tregjet e prokurimit, marrjen e nismave të përbashkëta për të përmirësuar njohuritë e përfaqësuesve të Autoriteteve Kontraktore etj.

Gjithashtu, AK në bashkëpunim me Bashkinë Berat, zhvilloi më datë 22 shtator 2023, Workshop-in me temë “Për rritjen e kulturës së konkurrencës dhe forcimin e bashkëpunimit me biznesin në procedurat e prokurimit publik në kuptim të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Në një bashkëbisedim interaktiv me pjesëmarrës nga komuniteti i biznesit në rrethin Berat, Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës, Z. Denar Biba diskutoi mbi specifikat kryesore të legjislacionit për mbrojtjen e konkurrencës, nevojën për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet biznesit dhe AK në funksion të zbulimit dhe ndëshkimit të marrëveshjeve të ndaluara në prokurimin publik, si dhe

rritjen e rolit proaktiv të ndërmarrjeve në garantimin e përputhshmërisë me rregullat e konkurrencës.

Në vijim të bashkëpunimit me botën e biznesit, në datën 19 dhjetor 2023, u zhvillua takimi me përfaqësues nga Shoqata Biznesi dhe Dhoma Tregtie me temë “Korniza legislative/ligjore për mbrojtjen e konkurrencës dhe nevoja për një rol më aktiv të Autoritetit të Konkurrencës në fushën e biznesit”.

Në këtë organizim morën pjesë përfaqësues nga dhomat e tregtisë, si ajo shqiptare, gjermane, amerikane etj, zyra ligjore dhe biznese të interesuara për njohjen më në detaje të legjislacionit mbi mbrojtjen e konkurrencës në Shqipëri.

AK ka vijuar bashkëpunimin me botën akademike duke zhvilluar më datë 14 dhjetor 2023, në ambientet e Fakultetit të Drejtësisë, Workshop-in me temë “Promovimi i mëtejshëm i kulturës së konkurrencës me botën akademike” në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, me pjesëmarrjen e Kryetarit të AK, Z. Denar Biba, përfaqësues të AK, profesorë dhe studentë në fushën e drejtësisë dhe ekonomisë.

Këto workshop-e dhe takime informative/edukuese do të vijojnë të organizohen nga Autoriteti i Konkurrencës për promovimin e mëtejshëm të kulturës së konkurrencës përmes intensifikimit të marrëdhënieve me botën akademike dhe të biznesit, për çështjet e rregullimit të tregut.

Eventi me i rëndësishëm i vitit 2023 ishte Konferenca Ndërkombëtare me temë “20-vjetori i ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” në Shqipëri: Pavarësia dhe roli i autoritetit në reformën rregullatore, zbatimin e ligjit, advokacia dhe sfidat drejt Integritimit në Bashkimin Evropian”, e cila u zhvillua në datat 23 dhe 24 nëntor 2023.

Kjo konferencë mbledhi së bashku ekspertë të autoriteteve homologe nga rajoni dhe Evropa; përfaqësues nga pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor; organet rregullatore, përfaqësues nga dhomat e tregtisë, si dhe pjesëmarrës nga bota akademike dhe e biznesit.

Konferenca u përshendet nga Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës, Z. Denar Biba; Kryetari i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, Z. Eduard Shalësi; Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Z. Gent Sejko; Përfaqësuesi i UNDP në Shqipëri, Z. Francisco Roquette dhe Zëvendës Ambasadori i Gjermanisë në Shqipëri, Z Thilo Schroeder.

Gjithashtu u zhvilluan diskutime në panele me tema si pavarësia e institucionit dhe roli i tij në reformën rregullatore, sfidat drejt integritimit në Bashkimin Evropian, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe zbatimin e ligjit të konkurrencës: antitrust dhe perqendrime.

## **PJESA E PESTË**

### **INTEGRIMI EVROPIAN dhe BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR**

#### **5.1 Kontributi në kuadrin e Integrimit Evropian**

Procesi i integrimit evropian përbën një nga prioritetet e veprimtarisë së AK. Si një institucion lider dhe koordinator për Kapitullin 8 “Politika e konkurrencës”, AK jep kontributin e tij në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE), raporton në mënyrë periodike pranë Kryenegociatorit, për “Tregun e brendshëm dhe konkurrencën”, si dhe jep kontributin e tij për Progres Raportin.

Në përputhje me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2023 - 2025, Autoriteti i Konkurrencës ka përbushur 100% këtë plan, duke miratuar brenda afateve kohore të përcaktuara, aktet nënligjore të parashikuara, në përputhje të plotë me legjislacionin evropian në fushën e konkurrencës.

- KK, me vendimin nr. 990, datë 08.06.2023, ka miratuar Udhëzuesin "Mbi udhëzimet jozyrtare për sa i përket çështjeve të reja ose të pazgjdhura në lidhje me nenet 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" për raste individuale”, në përputhje me Njoftimin e Komisionit mbi udhëzimet jozyrtare për sa i përket çështjeve të reja ose të pazgjdhura në lidhje me nenet 101 dhe 102 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian për raste individuale (letra udhëzuese) (C (2022) 6925 final).
- KK, me vendimin nr. 1043, datë 29.12.2023, ka miratuar “Manuali i procedurave për sjelljet antikonkurrese”, në përputhje me Manualin e Procedurave të sjelljeve anti-konkurrese (Dokument i Komisionit Evropian, Nëntor 2019).
- KK, me vendimin nr. 1040 datë 22.12.2023, ka miratuar Udhëzuesin "Mbi praktikat më të mira për zbulimin e informacionit në bazat e të dhënave, gjatë procedurave hetimore dhe të kontrollit të përqendrimeve të parashikuara në ligjin nr. 9121, datë 28.07.2023 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, në përputhje me Praktikrat më të mira për zbulimin e informacioneve në procedurat sipas neneve 101 dhe 102 të TFEU dhe sipas Rregullores së Përqendrimeve (2 Qershor 2015/Dokument i Komisionit Evropian).

Në kuadër të procesit të integrimit Evropian të vendit, në datat 6, 7 dhe 8 Mars 2023, u zhvillua në Bruksel, takimi “Bilateral Screening”, në të cilin Autoriteti i Konkurrencës (AK) - si lider dhe koordinator i Kapitullit 8 “Politika e Konkurrencës”, u përfaqësua nga Kryetari i AK, Z. Denar Biba dhe përfaqësues të tjerë të institucionit. Nga institucionet e tjera pjesë të këtij kapitullin, morën pjesë, përfaqësues nga Ndihma Shtetërore, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Ministria e Bujqësisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Kulturës dhe online përfaqësues nga Autoriteti i Aviacionit Civil. Gjatë tre ditëve tepër intensive, takimi pati në fokus prezantimet e përfaqësuesve të AK, për Kuadrin Ligjor dhe Institucional të Kapitullit të 8 “Politika



e Konkurrencës”; Rregullat Antitrust - Marrëveshjet e Ndaluar, Pozita Dominuese; Kontrolli i Perqendrimeve dhe prezantim i rasteve konkrete të zbatimit të Ligjit nr.9121/2003 “Për mbrojtjen Konkurrencës”.

Drejtuesit e takimit, pjesë e Komisionit European, paraqitën një sërë pyetjesh të cilat morën përgjigje konkrete nga përfaqësuesit e AK, duke u vlerësuar nga drejtuesit si një përfaqësim tepër korrekt dhe profesional.

- *Nënkomiteti “Tregu i Brendshëm dhe Konkurrueshmëria përfshirë Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit”*

Takimi i 14-të i Nën Komitetit të Stabilizim-Asocimit Bashkimi Evropian – Shqipëri “Tregu i Brendshëm dhe Konkurrueshmëria përfshirë Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit”, u zhvillua në 30 maj 2023 në Tiranë. AK paraqiti një raport të hollësishëm të aktivitetit të institucionit, lidhur me procesin e përafrimit të legjislacionit dhe nismat e parashikuara në të ardhmen, aktivitetet zbatuese dhe implementimin e ligjit si dhe lidhur me rritjen dhe forcimin e kapaciteteve institucionale. Përfaqësuesit e BE-së vlerësuan ndërhyrjet në treg nëpërmjet rasteve hetimore dhe vendimmarrjen e KK, rekomandimet e dhëna për institucionet qendrore e ato rregullatore, si dhe procesin e përafrimit dhe plotësimit të legjislacionit.

AK gjatë këtij viti ka përfunduar dokumentin e pasaportës për Kapitullin 8. Ku është pasqyruar e gjithë informacioni thelbësor për këtë kapitull.

## 5.2 Memorandume Bashkëpunimi

Në datën 24 nëntor 2023, në ditën e dytë të Konferencës Ndërkombëtare me temë “20-vjetori i ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” në Shqipëri: Pavarësia dhe roli i autoritetit në reformën rregullatore, zbatimi i ligjit, advokacia dhe sfidat drejt Integritimit në Bashkimin Evropian”, u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës dhe Komisionit të Mbrojtjes së Konkurrencës të Armenisë. Nënshkrimi i këtij memorandumi synon vendosjen e urave të reja të komunikimit dhe forcimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve në fushën e politikës së konkurrencës.

## 5.3 Bashkëpunimi Ndërkombëtar

### 5.3.1 Aktivitete

Gjatë veprimtarisë së vitit 2023, AK ka synuar forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare me institucionet homologe, forumet dhe qendrat e trajnimeve të konkurrencës në rajon e më gjerë. Stafit i AK është trajnuar në kuadër të bashkëpunimit me organizatat, si më poshtë vijon:

– Në kuadër të bashkëpunimit me **OECD - GVH/RCC** janë realizuar 4 seminare si më poshtë:

1. Në datat 14 - 16 shkurt u zhvillua nga RCC seminari me temë “Kontrolli i perqendrimeve në situata të paparashikuara”, në Budapest, Hungari, ku kanë marrë pjesë 2 punonjës.
  2. Në datat 28 - 30 mars u zhvillua nga RCC seminari me temë “Të drejtat e pronësisë intelektuale dhe politikës së Konkurrencës: Miq apo Armiq?”, në Budapest, Hungari, ku kanë marrë pjesë 2 punonjës.
  3. Në datat 19 - 21 shtator u zhvillua nga RCC seminari me temë “Advokacia e konkurrencës”, në Baku, Azerbajxhan, ku ka marrë pjesë 1 punonjës.
  4. Në datat 12 - 14 dhjetor u zhvillua RCC seminari me temë “Mjetet e zbulimit në inspektime”, në Budapest, Hungari, ku kanë marrë pjesë 2 punonjës.
- Në kuadër të bashkëpunimit me **ICN, OECD, KE, ABA, Instituti Joint Vienna, Sekretariati i Energjisë, OBT dhe Autoritete homologe**, janë organizuar aktivitete si më poshtë:

➤ *4 Konferenca:*

1. Në datën 10 Tetor u zhvillua nga Autoriteti i Konkurrencë së Republikës së Kosovës Konferenca me temë “Dita e Konkurrencës 2023: Përfitimet e konkurrencës së drejt në Kosovë”, në Prishtinë, Kosovë, ku kanë marrë pjesë 2 punonjës.
2. Në datat 18 - 20 tetor u zhvillua nga ICN në bashkëpunim me Komisionin Kombëtar Spanjoll të Tregjeve dhe Konkurrencës “Konferenca Vjetore 2023”, në Barcelonë, Spanjë, ku ka marrë pjesë 1 punonjës.
3. Në datat 8 - 9 nëntor u zhvillua nga Autoriteti Portugez i Konkurrencës “Konferenca e VI-të e Lisbonës për të drejtën e konkurrencës dhe Ekonominë”, në Lisbonë, Portugali, ku ka marrë pjesë 1 punonjës.
4. Në datat 16 - 18 nëntor u zhvillua nga Agjensia Gjeorgjiane e Konkurrencës “Konferenca e II-të Ndërkombëtare për Konkurrencën dhe të Drejtën e Konsumatorit”, në Tbilisi, Gjeorgji, ku ka marrë pjesë 1 punonjës.

- *2 Forume:*

1. Në datën 20 prill u zhvillua nga Sekretariati i Energjisë “Forumi për Legjislacionin Evropian të Energjisë”, në Vienë, Austri, ku ka marrë pjesë 1 punonjës.
2. Në datat 7 - 8 dhjetor u zhvillua nga OECD “Forumi Global i Konkurrencës”, në Paris, Francë, ku kanë marrë pjesë 3 punonjës.

- *2 Workshop-e dhe 1 Seminar:*

1. Në datat 7 - 8 mars u zhvillua nga ICN, Workshop-i me temë “Zhvillimi dhe sfidat e zbatimit të politikës së konkurrencës në rastin e sjelljes së njëanshme”, në Tokio, Japoni, ku ka marrë pjesë 1 punonjës.

2. Në datat 10 - 12 korrik u zhvillua nga Organizata Botërore e Tregëtisë Workshop-i me temë “Politikën e konkurrencës, tregëtisë dhe zhvillimit”, në Gjënevë, Zvicër, ku ka marrë pjesë 1 punonjës.
3. Në datat 2 - 3 tetor u zhvillua nga Komisioni European seminari me temë “Ndihma Shtetërore dhe Konkurrenca”, në Bruksel, Belgjikë, ku kanë marrë pjesë 2 punonjës.

- *Të tjera:*

1. Në datat 29- 31 mars u zhvillua nga ABA Takimi Pranveror mbi Legjislacionin Antitrust, në Washington, SHBA, ku ka marrë pjesë 1 punonjës.
2. Në datat 20 – 24 shkurt u zhvillua nga Joint Vienna Institute dhe Fondi Ndërkombëtar Monetar, trajnimi me temë “Parashikimi i së adhmes (Nowcasting)”, në Vienë, Austri, ku ka marrë pjesë 1 punonjës.

Në kuadër të bashkëpunimit me **CREESE**, janë organizuar 3 aktivitete si më poshtë:

- Në datat 24 qershor - 6 korrik u zhvillua nga Shkolla verore CREESE, Kursi me temë “Politikën e konkurrencës dhe rregullore”, në Rodos, Greqi, ku kanë marrë pjesë 3 punonjës.
- Në datat 30 qershor - 3 korrik u zhvillua nga Shkolla verore CREESE, Kursi për juristë me temë “Roli i ekonomisë në zbatimin e ligjit të konkurrencës dhe praktika”, në Rodos, Greqi, ku kanë marrë pjesë 4 punonjës.
- Në datat 1 korrik - 5 korrik u zhvillua Programi ekzekutiv CALEP ”, në Rodos, Greqi, ku kanë marrë pjesë 3 punonjës.

## **PJESA E GJASHTË**


### **ORGANIZIMI I AUTORITETIT**

#### **6.1 Organizimi i Autoritetit të Konkurrencës**

Për vitin 2023, Autoriteti i Konkurrencës, në funksion të përmbushjes së detyrimeve në zbatim të ligjit nr. 9121/2003, ka pasur si objektivi strategjik të tij, për t’u afruar sa më shumë me modelin institucional të institucioneve homologe të vendeve të BE. Autoriteti i Konkurrencës është i organizuar nga një numër prej 49 punonjësish, sipas strukturës së miratuar me Vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 42/2023 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Vendimin e Kuvendit nr. 43/2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës të Autoritetit të Konkurrencës”.


Për sa më sipër, AK ka kërkuar dhe është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë një shtesë prej 3 (tre) inspektorësh, për shkak të shtimit të numrit të hetimeve (paraprake dhe të thelluara), monitorimeve në terren dhe nevojës për të patur ekspertë të dedikuar për integrimin në BE, për të mbuluar aktivitetin në rritje, për të gjitha tregjet në territorin e RSH, me qëllim plotësimin

e nevojave të konsumatorit shqiptar, nëpërmjet një konkurrence të lirë dhe efektive si në tregjet prodhuese dhe ato të shërbimit. Rritja e numrit të punonjësve do të sigurojë që analizat, studimet, inspektimet dhe gjithë procedurat hetimore të kryhen më shpejt.



## 6.2 Realizimi i buxhetit për vitin 2023

Gjatë vitit 2023, përdorimi i buxhetit të miratuar për AK ka qenë konform kërkesave të ligjit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe është përdorur me efikasitet për plotësimin e kushteve dhe kërkesave të punonjësve, për realizimin e detyrave të ngarkuara për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg.



- 606, Ndihma ekonomike
- 601, Kontribute për Sigurime Shoqërore
- 602, Materiale dhe Shërbime
- 600, Paga, Shpërblime, Etj
- 231, Investime

Kodi	Emërtimi	Plani (me ndryshime)	Fakti	%
<b>600</b>	Paga, shpërblime etj	72'371'270 Lekë	72'001'883 Lekë	99%
<b>601</b>	Kontribute për sigurime shoqërore	11'340'000 Lekë	11'195'385 Lekë	99%
<b>602</b>	Materiale dhe shërbime	10'410'000 Lekë	9'812'442 Lekë	94%
<b>606</b>	Ndihma ekonomike	740'000 Lekë	521'536 Lekë	70%
<b>231</b>	Investime	5'000'000 Lekë	4'519'160 Lekë	90%
<b>Totali</b>		<b>99'861'270 Lekë</b>	<b>98'050'386 Lekë</b>	<b>98%</b>

### 6.3 Të ardhurat e realizuara


Gjatë këtij viti, në buxhetin e shtetit është derdhur si e ardhur nga perqendrimet (njoftime dhe autorizime perqendrimi) deri më 31 dhjetor 2023 shuma 30,738,335.33 lekë. Të ardhurat e arkëtuara në buxhetin e shtetit nga vjelja e gjobave deri më 31 dhjetor 2023 në shumën 15,526,524 lekë.

Të ardhura të arkëtuara	Viti
	2023
Nga procedurat e perqendrimeve	30,738,335,.33
Nga gjobat	15,526,524
<b>Total</b>	<b>46,264,859.33</b>

### 6.4 Trajnimet dhe rekrutimet

Gjatë vitit 2023, në kuadër të plotësimit të nevojave të drejtorive teknike janë realizuar 5 procedura rekrutimi me ngritje në detyrë dhe pranim në shërbimin civil. Të gjitha procedurat janë realizuar konform kërkesave të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Gjatë vitit 2023 janë realizuar 18 trajnime jashtë vendit dhe webinarë informuese nga ASPA. Është trajnuar pothuaj i gjithë stafi teknik i institucionit, ku një pjesë e punonjësve rezulton të jenë trajnuar më shumë se një herë. Të gjitha trajnimet jashtë vendit janë realizuar në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar të AK me ICN, RCC, OECD, KE, ABA, Instituti Joint Vienna, Sekretariati i Energjisë, OBT, CREESE dhe ato brenda vendit nga Shkolla e Administratës Publike (ASPA).





■ Legjislacion ■ Ekonomi ■ Energji ■ Advokaci



■ Legjislacion ■ Ekonomi ■ Energji ■ Advokaci

## **PJESA E SHTATË**

### **PRIORITETET E AK PËR VITIN 2024**

#### **7.1 Prioritetet e AK për vitin 2024**

Autoriteti i Konkurrencës, në përputhje me qëllimin e ligjit nr. 9121/2003, për një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, do të vazhdojë monitorimet, hetimet dhe analizat në tregjet sensitive dhe me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqenien e konsumatorit shqiptar, si:

- Tregu i telefonisë celulare
- Tregu i materialeve të ndertimit, cemento.
- Tregu i ofrimit të shërbimit taksi nga dhe drejt Aeroportit “Nënë Tereza”.
- Tregu i prokurimeve
- Tregu i administrimit dhe mirëmbajtjes së ashensorëve pranë rezidencave të banimit të qarkut të Tiranës.
- Tregu i prodhimit të qumështit dhe nënproduktet e tij
- Tregu i grumbullimit të produkteve bujqësore.

Autoriteti i Konkurrencës do të vlerësojë rast pas rasti sjelljen e ndërmarrjeve të cilat gëzojnë pozitë dominuese nëpërmjet marrëveshjeve koncesionare.

#### **7.2 Përafrimi institucional me standardet dhe praktikat e BE**

Disa nga prioritetet e PKIE 2023 - 2025 në fushën e konkurrencës janë hartimi i disa udhëzimeve për te plotësuar kuadrin ligjor dytësor dhe konkretisht:

- Në tremujorin e tretë të vitit 2024 është parashikuar miratimi nga ana e Autoritetit të Konkurrencës i aktit ‘Udhëzim "Mbi referimin e rasteve në lidhje me përqëndrimet”’, në përputhje me aktin e acquis ‘Njoftim i Komisionit për referimin e rasteve në lidhje me përqëndrimet (2005/C 56/02)’.
- Në tremujorin e katërt të vitit 2024 është parashikuar miratimi nga ana e Autoritetit të Konkurrencës i aktit ‘Udhëzim "Mbi marrëveshjet kolektive në lidhje me kushtet e punës së të vetëpunësuarve’, në përputhje me aktin e acquis ‘Udhëzim për zbatimin e të drejtës së BE-së për konkurrencën mbi marrëveshjet kolektive në lidhje me kushtet e punës së të vetëpunësuarve 2022/C 374/02’.
- Forcimin e kapaciteteve administrative, nëpërmjet trajnimit të stafit të ri dhe ekzistues me qëllim rritjen e cilësisë së monitorimit, inspektimit, hartimit të raporteve, analizave, mbrojtjes së vendimeve të KK në proceset gjyqësore, në të gjitha shkallët e gjyqësorit.
- Adresimin në mënyrë të përshtatshme dhe domethënëse të çështjeve sensitive (trajtimi i ankesave), si dhe bashkëpunimin me institucionet e administratës qendrore dhe vendore,



entet dhe institucionet e tjera rregullatore për rregullimin e veprimtarisë ekonomike në territorin e RSH për të siguruar një konkurrencë efektive në treg.

- Angazhohet në rritjen e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe ente rregullatorë, duke nënshkruar me to edhe memorandume mirëkuptimi (MOU).
- Autoriteti i Konkurrencës do të jetë përfitues i një projekti me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për asistencë teknike dhe suport për zbatimin e strategjisë së advokacisë.